

MREKULLIA E KRIJIMIT NË ADN

Harun JAHJA

HYRJE: KTHESË E MADHE NË HISTORINË E NJERËZIMIT

Sot është dita e një kthese të madhe në histori. Filozofia materialiste, e cila njëherë i qe imponuar njerëzimit nën trajtën e shkencës, ironikisht po rrëzohet sot nga vetë shkenca. Materializmi, filozofia sipas së cilës gjithqka është e përbërë nga materia dhe i cili e mohon ekzistencën e Perëndisë, është në fakt një version bashkëkohor i paganizmit. Paganët e vjetër i adhuronin gjësendet e vdekura siç ishin idhuajt nga druri apo guri dhe i konsideronin ato për qenie hyjnore. Filozofia materialiste, në anën tjetër, e bazon pohimin e saj në besimin se njeriu dhe të gjitha qeniet tjera janë të krijuara vetëm nga atomet dhe molekulat. Sipas kësaj pikëpamjeje supersticioze, atomet jo të gjalla në njëfarë mënyre e organizuan vetveten dhe me kohë fituan jetë e vetëdije, duke e sjellur finalisht kështu në ekzistencë njeriun.

Ky besim superstitioz i bazuar në materializëm quhet ‘**evolucion**’. Besimi në evolucionin, i paraqitur për herë të parë në kulturat pagane të Sumerianëve të vjetër dhe të Grekëve antikë, në një mënyrë u ringjall në shekullin e nëntëmbëdhjetë nga një grup i shkencëtarëve materialistë, dhe kështu u soll në agjendën botërore. Charles Darwin është më i njohuri nga këta shkencëtarë. Teoria e evolucionit të cilën ai e zhvilloi e humbi kot kohën e botës së shkencës për 150 vite, dhe megjithë natyrën e saj me të meta, gjë kjo gjërisht e pranuar, ajo mbijetoi deri tash vonë për arsye të thjeshtë ideologjike.

Sidoqoftë, siç u përmend edhe më herët, sot materializmi po falimenton me një zhurmë gjëmuese. Shpesh thuhet se ishin tre teoretë të njohur materialistë të cilët manovruan shekullin XIX: Frojdi, Marksi dhe Darvini. Teoritë e dy të parëve u studiuuan, testuan dhe duke u vërtetuar për jovalide, u mohuan pastaj në shekullin e njëzetë. Tashmë, edhe teoria e Darvinit po kapitullon në të njëjtën mënyrë.

Disa zhvillime të rëndësishme në Qershorin e vitit 2000 e lehtësuan këtë rrëzim të madh të materializmit.

Së pari, disa shkencëtarë të cilët po kryenin disa eksperimente për të thyer shpejtësinë e dritës, bënë një zbulim që ndryshoi tërësisht drejtimin e të gjitha premisave shkencore. Në një eksperiment ku u thye shpejtësia e dritës, shkencëtarët observuan me mahnitje se **efekti i eksperimentit ngjau para shkakut të tij**. Kjo do të thoshte disfatë për qëndrimin e “**shkakësisë-kausalitetit**”, i cili qe vendosur në themele të pikëpamjeve materialiste në shekullin 19. Në shumë publikime shkencore u raportua se “**ky eksperiment vërtetoi se është i mundshëm efekti-pasoja pa shkak dhe se fundi i një ngjarjeje mund të ndodhë para fillimit të saj.**” Në të vërtetë, të ndodhurit e efektit të një veprimi para veprimit që duket të jetë shkak i tij, është fakt shkencor se të gjitha ngjarjet janë krijuar individualisht. Kjo tërësisht e shembë dogmën materialiste.

Disa javë më vonë u zbulua se **Arheopteriksi, shpendi fosil i paraqitur si ‘ fakti më i rëndësishëm fosil’ nga Darwinistët për më shumë se një shekull, ishte në të vërtetë jo fakt, por goditje fatale për teorinë e evolucionit**. Kur u zbulua një fosil tjetër që nuk

kishte dallim nga shpendtë e tashëm dhe ishte nja 75 milion vite më i vjetër se ky fosil (Arheopteriksi) që gjoja është ‘paraardhësi primitiv i shpendëve’, evolucionistët u shokuan. **Shumë revista që e kishin paraqitur më herët Arheopteriksin si ‘paraardhësin primitiv të shpendve’** u detyruan tash të raportojnë se **‘Paraardhësi si shpendëve u vërtetua të jetë shpend’**.

Përfundimisht, **projekti i gjenomit njerëzor** - një përpjekje për të krijuar hartën e përafërt të gjenomit njerëzor, u konkludua dhe kështu u **bënë të njohura për njerëzimin detajet e ‘informacionit gjenetik’ të cilat e bënë të njohur faktin se sa i madhërisht është krijimi i qenieve të gjalla nga Perëndia**. Sot, secili që i mer në konsideratë rezultatet e këtij projekti dhe që e sheh se një qelizë e vetme njerëzore përmban mjaft informata sa për tu deponuar në mijëra faqe enciklopedishë, e kupton se qfarë mrekullie e madhe e krijimit është kjo.

Prapëseprapë, evolucionistët përpiqen që ti keqinterpretojnë zbulimet e fundit, të cilat në fakt flasin kundër tyre, dhe ti paraqesin ato si fakt për “evolucionin”. Të paaftë për të sqaruar se si e ka origjinën qoftë edhe zingjiri i AND-së së një bakteri të vockël, evolucionistët tentojnë të përhapin mesazhe si ky “gjenet njerëzore u përngjajnë gjeneve shtazore”. Mesazhet e tilla janë të pasakta dhe nuk kanë ndonjë vlerë shkencore. Këto mesazhe janë dizajnuar për të udhëzuar mbrapsht shoqërinë. Në ndërkohë, disa institucione shtypi, për shkak të injorancës së tyre ndaj kësaj teme dhe për shkak të qasjes së njëanshme, supozojnë se Projekti i Gjenomit Njerëzor paraqet ‘fakte për evolucionin’ dhe mundohen ta prezantojnë këtë në atë mënyrë.

Në këtë libër janë sqaruar keqinterpretimet e mësipërme evolucioniste dhe është qartësuar natyra e cektë dhe iracionale e vërejtjeve të ngritura ndaj qështjes së krijimit. Përveq kësaj këtu është zbuluar në mënyrë eksplicite ashpërsia e rrënimit të Darwinizmit me zbulimet e fundit.

Kur ti e lexon këtë libër, do ta shohësh gjithashtu se filozofia materialiste e cila e mohon Perëndinë po e arrin fundin e saj dhe se në shek. 21 njerëzimi do ti kthehet pranimit të qëllimit të njëmendtë të krijimit duke u çliruar nga mashtrimet si evolucioni.

ADN: BURIMI I TË DHËNAVE TË JETËS

Progresi i shkencës e tregon qartë se qeniet e gjalla kanë një strukturë dhe rend skajshmërisht kompleks i cili është tepër i përsosur për të ardhë në ekzistencë rastësisht. Ky është fakt se qeniet e gjalla janë krijuar nga një Krijues i Gjithëfuqishëm me njohuri superiore. Tash vonë për shembull me shpleksjen e strukturës perfekte të gjenit njerëzor – gjë kjo që u bë qështje prominente për shkak të Projektit të Gjenomit – krijimi unik i Zotit u zbulua edhe një herë për të gjithë.

Shkencëtarët nga e tër bota, prej SHBA-ve deri në Kinë, kanë dhënë përpjekjet e tyre më të mira gjatë më shumë se një dekade, për të deshifruar 3 bilion shkronjat kimike të ADN-së dhe për të përcaktuar sekuencën e tyre. Si rezultat i kësaj, 85% të të dhënave që përfshihen në AND-në e njerëzve mund të renditen në mënyrë të duhur. Edhe pse ky është një zhvillim shumë ngacmues dhe i rëndësishëm, siç thotë edhe Dr. Francis Collins i cili e

udhëheq Projektin e Gjenomit Njerëzor, tani për tani është marrë vetëm hapi i parë në deshifrimin e informatave që gjenden në ADN.

Për të kuptuar se pse deshifrimi i këtyre informatave merr kaq shumë kohë, ne duhet ta kuptojmë natyrën e informatave të deponuara në ADN.

Struktura sekrete e ADN-së.

Në fabrikimin e produkteve teknologjike apo në menagjimin e një fabrike, mjetet më të mëdha të punësuar janë përvoja dhe akumulimi i njohurisë që i ka fituar njeriu gjatë shumë shekujve. Njohuria dhe përvoja e nevojshme për ndërtimin e trupit njerëzor, “fabrikës” më të avancuar dhe sofistikuar në botë, janë të deponuara në ADN. ADN është një molekulë e madhe që ruhet me kujdes në bërthamën qelizore dhe që funksionon si një bankë e të dhënave për trupin e njeriut. Informatat e fshehura brenda ADN-së kontrollojnë qindra ngjarje të ndryshme që ndodhin në qelizat e trupit të njeriut dhe në funksionimin e sistemit të tij, sikur edhe në qështjet fizike, që nga ngjyra e flokëve dhe syve të personit e deri te lartësia e tij. Për shembull, edhe nëse shtypja e gjakut të dikuj është e lartë, e ulët apo normale, mvaret nga informatat në ADN.

Një qështje e rëndësishme që duhet potencuar këtu është se qysh nga krijesa e parë njerëzore, trilionat shembujt e ADN-së në biliona qelizat e njeriut janë paraqitur në gjendjen e njëjtë të përsosshmërisë dhe kompleksitetit siç janë edhe sot. Duke i lexuar rreshtat e mëposhtëm ti poashtu do të shohësh se sa e paarsyeshme është të pohohet, ashtu siç bëjnë evolucionistët, se gjoja një molekulë e tillë, me strukturën dhe mundësitë e saj marramendëse, është krijuar si rezultat i rastësisë.

Vëllimet e informatave në Qelizën Njerëzore

Informatat e deponuara në ADN nuk duhet të nënqmhohen në asnjë mënyrë. Për më tepër pasi që një molekulë ADN e njeriut përmban mjaftë informata sa për të mbushur miliona faqe enciklopedishë, apo për të mbushur rreth 1000 libra. Vëreje me vëmendje këtë fakt: një milion faqe enciklopedie, apo 1000 libra. Pra kjo do të thotë se bërthama e çdo qelize përmban aq informata sa për të mbushur një milion faqe enciklopedie, informata këto që përdoren për kontrollin e funksioneve të trupit të njeriut. Për të tërhequr një analogji ne mund të pohojmë se edhe 23 volumet e Enciklopedisë Britanike, njërës nga minierat më të mëdha të informacioneve në botë, kanë vetëm 25000 faqe. Kështuqë para nesh qëndron një pamje e habitshme. Në një molekulë të gjetur në bërthamë, e cila është shumë më e vogël se sa qeliza mikroskopike ku ajo është e vendosur, ekziston një depo e të dhënave 40 herë më e madhe se sa enciklopedia më e madhe e botës e cila përmban me miliona artikuj informacioni. Kjo do të thotë se kemi një enciklopedi 1000 volumësh e cila është unike dhe nuk ka diqka që mund të krahasohet me të. Kur një pjesë e informacionit prezente në gjenin e njeriut do të lexohet çdo sekondë, non-stop, do të duheshin 100 vite për ta kompletuar këtë proces. Nëse informatat që gjenden në ADN do të vendoseshin në formë libri, vëllimet e vendosura në majë të njëra tjetrës do të mbërrinin 70 metra lartësi. Llogaritjet e fundit kanë zbuluar se kjo enciklopedi gjigante përmbanë një 3 bilion “tema” të ndryshme. Nëse informatat e ADN-së do të shkruheshin në letër, ajo letër do të zgjatej nga Poli i Veriut deri në Ekuador.

Këta shembuj janë indikacion i sasisë madhështore të informatave që gjenden në ADN. Tash shtrohet pyetja, si mund të bëhet fjalë për molekulë që përmban informata. Kjo për arsye sepse ajo për qka ne po flasim nuk është kompjuter apo bibliotekë, por vetëm një pjesë e trupit që është me qindra mijëra herë më e vogël se një milimetër, e përbërë thjeshtë nga proteina, yndyra dhe molekula uji. Do të ishte një mrekulli me përmasa mahnitëse sikur kjo pjesë pambarimisht e vogël e trupit do të përmbante dhe depononte qoftë edhe një informatë të vetme e të mos flasim për miliona informata të tilla.

Kompjuterët janë momentalisht format më të përparuara të teknologjisë për deponimin e informatave. Sasia e informatave e cila para 30 viteve në mënyrë rutine deponohej në një kompjuter me madhësi sa të një dhome, sot mund të deponohet në disqe të vogla, por edhe teknologjia më e re e zbuluar nga intelijenca njerëzore, pas diturisë së akumuluar me shekuj dhe punës së mundimshme, akoma është larg nga arritja e kapacitetit deponues të informatave që ka një bërthamë e vetme qelizore. Krahasoni në vijim i bërë nga profesori i mirënjohur i mikrobiologjisë Michael Denton, mbase do të mjaftojë për të ndrikuar kontrastin midis madhësisë së vockël të ADN-së dhe sasisë së madhe të informatave që ajo përmban:

Informatat e nevojshme për të specifikuar dizajnin e të gjitha specieve të organizmave që kanë ekzistuar ndonjëherë në planetë, një numër i cili sipas G.G. Simpson arrin në përafërsisht një mijë milion, do të mund të mbaheshin në një lugë qaji dhe akoma do të kishte vend aty për të gjitha informatat që gjenden në secilin libër të shkruar ndonjëherë.¹

Si mundet një zingjir i padukshëm për syrin, i përbërë nga atomet, me diametër sa e një bilionta pjesë e milimetrit, të përmbajë një memorie të tillë dhe një kapacitet të tillë informatash? Kësaj pyetje shtoja edhe këtë tjetrën: Përdesisa secila nga 100 trilion qelizat e trupit tënd i dinë përmendësh një milion faqe informacioni, ti si një qenie njerëzore inteligjente dhe e vetëdijshme, sa faqe enciklopedie do të mund t'i memorizojë gjatë tërë jetës tënde. Diqka që është edhe më e rëndësishme, qeliza i përdorë këto informata në mënyrë të rrjedhshme, në një mënyrë tejmasë të planifikuar dhe koordinuar, në vendet e duhura dhe kurrë nuk bën ndonjë gabim. Akoma para se njeriu të vijë në ekzistencë, qelizat e tij veqse kanë filluar procesin e ndërtimit të tij.

Qelizat: Njësitë Ndërtuese të Njerëzve

Fekondimi i qelizës vezë nga spermatozoidi do të thotë fillimi i jetës së re njerëzore. Miliona spermatozoide garojnë për të fekonduar qelizën vezë, por vetëm një nga ta arrin ta bëjë këtë. Megjithatë, kjo garë nuk i është lënë shansit apo rastësisë, pasi që çdo fazë e saj është krijuar nga Zoti me përmasa të fiksuara. Perëndia e shpallë këtë të vërtetë në ajetin e shenjtë:

“Ne u kemi krijuar juve, e përse nuk pranoni? A keni menduar për farën që e dredhni. A ju e krijoni atë, apo Ne jemi që e krijojmë?” (Kur’ani 56:57-59)

Kur qeliza spermatozoide e babait e fekondon qelizën vezë të nënës, gjenet e prindërve bashkohen dhe përcaktojnë karakteristikat fizike të foshnjës që eventualisht do të

lindet. Secili nga mijëra gjenet e ndryshme e ka një funksion të veçantë. Janë gjenet ato që e përcaktojnë ngjyrën e flokëve dhe syve, formën e fytyrës dhe detaje tjera të panumërta në skelet, organe të brendshme, tru, nerva dhe muskuj.

Kur sperma bashkohet me qelizën vezë, formohet një qelizë – themeli i qenies së re njerëzore - dhe bashkë me atë qelizë formohet gjithashtu kopja e parë e molekulës së ADN-së, të cilat do ta bartin kodin gjenetik të personit brenda secilës qelize përgjatë tërë jetës së tij.

Në mënyrë që kjo qelizë e parë, veza e fekunduar, të zhvillohet në qenie njerëzore, ajo duhet të shumëhet, dhe në bazë të kësaj ajo fillon të ndahet me një vetëdije të mrekullueshme. Kjo vetëdije e zbulon vetveten në fazën e ardhshme. Duke u ndarë qelizat ato fillojnë të rriten ndryshëm dhe shkojnë në ato pjesë të trupit ku ato nevojiten. Në vend të një mase trupi të përbërë nga qeliza saktësisht të njëjta, disa nga to shëndërrohen në qeliza syri dhe shkojnë aty ku nevojiten, të tjerat formojnë qelizat e zemrës dhe shkojnë në gjoks, dhe prapë disa të tjera shëndërrohen në qeliza lëkure dhe e mbulojnë tërë trupin. Të gjitha qelizat shumëhen aq sa nevojitet për indin e veçantë të cilin ato do ta konstruktojnë, dhe fillojnë të bashkohen duke i dhënë indit strukturën që i nevojitet, duke filluar kështu krijimin e organeve të ndryshme.

Koordinimi i këtij diferencimi dhe strukturimi është bërë i mundur nga molekula e ADN-së. Ne nuk duhet ta lëmë mënjatë faktin se ADN nuk është as biokimist që punon në laboratore të mbushura plot nga pajisjet më të reja, e as një super – kompjuter i aftë për të kryer trilionat kalkulime në sekondë. ADN është molekulë e krijuar nga atome si karboni, fosfori, azoti, hidrogjeni dhe oksigjeni.

Le të kemi tani parasysh faktet vijuese: Trilionat qelizat në trupin e njeriut shumëhen me ndarje. Sidoqoftë gjenet e ndryshme në qelizat e ndryshme aktivizohen në kohëra të ndryshme, dhe me këtë i lejojnë qelizës që të diferencohet. Ose thënë ndryshe, çdo qelizë që ndahet dhe shumëhet pas qelizës së parë, përmban kompletin e informatave gjenetike. Me fjalë tjera, çdo qelizë e vetme posedon mundësinë për të prodhuar muskulin e zemrës, lëkurën, qelizat e kuqe të gjakut apo qfarëdo indi tjetër në trup. Edhe pse secila qelizë përmbanë përshkrimin e tërësishëm gjenetik të tërë trupit, vetëm disa gjene janë aktive në kohëra të ndryshme në organe të ndryshme. Për shembull, çdo qelizë përmbanë kodet për zhvillimin dhe funksionimin e veshkëve, sidoqoftë vetëm gjenet relevante janë aktive në atë organ, në kohëra të caktuara në fazën e zhvillimit. Njëjtë me këtë, enzimet e caktuara, psh glukozo-6-fosfati, gjenden kryesisht në mushkëri. Edhe pse të gjitha qelizat e të gjitha organeve të tjera e posedojnë përshkrimin e kësaj proteine ato kurrë nuk e prodhojnë atë. Qelizat e syrit kurrë nuk e bëjnë; për shembull ato krijojnë vetëm atë që është e nevojshme për syrin: qelizat nervore do të bartin porositë në tru dhe nga truri në organe, qelizat e mushkërive do të purifikojnë toksinet dhe qelizat yndyrore do të deponojnë ushqimin për kohën kur do të ketë mungesë ushqimi. Asnjë nga to kurrë nuk gabon dhe për shembull të prodhojë enzimet e lukthit. Pra kush e bartë sipër këtë divizion të përsosur pune? Kush i urdhëron qelizat që të specializojnë në fusha të ndryshme pasi që ato të jenë ndarë dhe shumëuar? Për më tepër, si mundet që të gjitha qelizat të binden me aq vetëdije, dhe kë e dëgjojnë ato derisa punojnë me një disiplinë dhe organizim kaq të patëmetë? Është shumë

e qartë se asnjë nga këto nuk janë sisteme të rastësishme të formuara si rezultat i akoma rastësive të tjera.

Kjo përsoshmëri nuk përfundon me faktin se qelizat paraqiten në vendin e duhur dhe në kohën e duhur, dhe vënë në funksion gjenet e duhura. Qelizat duhet gjithashtu të jenë prezente në fazat përkatëse të jetës, dhe atë në sasi të duhur. Gjenet tona ‘riparuese’ punojnë gjatë tërë kohës në gati të gjitha qelizat tona. Gjenet tjera funksionojnë vetëm në disa qeliza në periudha kritike gjatë jetës, duke punuar për vetëm disa orë para se të shkojnë në gjendje gjumi. Për shembull prodhimi i qumështit mundësohet nga gjenet gjatë gjdhënies. Informata ekzistuese aktivizohet në kohën e duhur, në sasinë e duhur dhe në vendin e duhur. Përdorimi i “koincidencës” nga evolucionistët për të sqaruar këtë vetëdije, planifikim, përcaktim, llogaritje, drejtim inteligjent dhe përdorim të të bilionave pjesë të informatave që gjenden në ADN, në fakt nuk është sqarim aspak. Asnjë sistem në botë, as edhe më i thjeshti nuk mund të vijë në ekzistencë nga rastësia, kështuqë është skajshmërisht jologjike të shihen si rastësi ndodhitë e planifikuara dhe të organizuara që ngjajnë në nivel të hapësirës mikroskopike. Në të vërtetë, evolucionistët e pranojnë se ata janë larg nga ofrimi i sqarimit për këtë diferencim dhe ndarje të punëve në qelizë. Mikrobiologu evolucionist Profesor Ali Demirsoy dëshmon:

Në esencë nuk është vërtetuar akoma asnjë sqarim i kënaqshëm për zhvillimin e grupeve të qelizave me struktura dhe funksione shumë të ndryshme.²

Të gjitha këto ngjarje të jashtëzakonshme nuk mundën thjeshtë të llogariten në terme të rastësive apo sikur ato janë vepër e vetë qelizave. Pra, kush i drejton këto zhvillime që ngjajnë në qelizë, i krijon ato për qëllime të caktuara, dhe posedon inteligjencën dhe fuqinë për që paraqitur biliona pjesë të informatave në një sipërfaqë të tillë të vockël, të pakapshme për syrin e njeriut?

Mençuria në Qelizë

Në këtë rast ti duhet ta pranosh se qfarëdo qelize në stomakun apo veshin tënd është më e ditur se sa ti, dhe pasiqë ajo i përdor informatat e përmendura në mënyrën më korrekte dhe perfekte, ajo është edhe më e menqur se ti.

Por ku është burimi i kësaj menqurie? Si është e mundur që secila nga 100 trilion qelizat e trupit të njeriut posedon këtë aftësi, informatë dhe inteligjencë të pabesueshme? Në fund të fundit këto janë vetëm një grumbull i atomeve dhe pastaj janë edhe të pavetëdijshme. Merri atomet e të gjitha elementeve, kombinoji në forma dhe numra të ndryshëm, do të fitosh molekula të ndryshme, por akoma kurrë nuk mund të fitosh ndonjë menquri. Qofshin këto molekula të vogla apo të mëdha, të thjeshta apo komplekse, kjo nuk ka fare rëndësi. Kurrë nuk do të mund të fitosh një mendje që me vetëdije do të organizonte ndonjë proces dhe do ta kryente atë.

Si mund të ndodhë atëherë që molekula e ADN-së, e kompozuar nga mbarështimi i numrit të caktuar të atomeve të pamenqura dhe pavetëdije në sekuenca të caktuara, dhe enzimeve, të punojë në mënyrë të harmonishme, të ketë aftësi të organizojë veprime të panumërta të komplikuara dhe të ndryshme në mënyrën më të përsosur dhe më komplete në qelizë? Përgjegjja në këtë është shumë e thjeshtë; menquria nuk është në këto molekula apo

në qelizat ku ato gjenden, por në atë që i ka krijuar këto molekula, që i ka programuar ato të funksionojnë sikurse funksionojnë. Thënë shkurt, menquria është prezente jo në veprën e bërë, por në krijuesin e asaj veprë.

Edhe kompjuteri më i zhvilluar është produkt i menqurisë dhe intelektit që ka shkruar dhe instaluar programet e tij, dhe pastaj e ka përdorur atë. Njësoj, qeliza, ADN dhe ARN në të, dhe njeriu i përbërë nga qeliza të tilla nuk janë asgjë veqse vepra të Atij që i ka krijuar ato sikur edhe atë që ato bëjnë. Pa marrë parasysh se sa e përkryer, komplete dhe e mahnitshme është vepra, menquria gjithmonë qëndron në pronarin e veprës.

Nëse ti do ta shihje një fjali të kuptimtë në fletoren tënde në tavolinë, a nuk do të ishe kureshtar për ta ditur kush e ka shkruar atë. Ti kurrë nuk do të mendoje se fletorja, lapsi dhe ngjyra u bashkuan si rezultat i erës dhe e shkruan atë fjali. Në ADN ne kemi të bëjmë me biliona pjesë të informatave, secila nga to kruciale për qenien njerëzore.

Hë pra, pse nuk e bëjmë të njëjtën pyetje rreth qelizës? Nëse informata në kompjuter apo në fletore është shkruar nga dikush, kush e ka “shkruar” atëherë ADN-në e cila ka teknologji shumë më superiore dhe më të avancuar, është dizajnuar në mënyrën më të përkryer, është krijuar dhe vendosur në qelizën e imtë, e cila nga ana tjetër është një mrekulli tjetër në vetvete? Përveq kësaj, deri më sot ajo nuk ka humbur asnjë nga aftësitë që i ka pasur me mijëra vite. Çka mund të jetë për ty më e rëndësishme se sa të pyetesh: Kush dhe pse i ka krijuar këto qeliza, të cilat funksionojnë non-stop në mënyrë që ti të mund të lexosh këta rreshta, të shohësh, të marrësh frymë, të mendosh, thënë shkurt të ekzistosh dhe të vazhdosh të ekzistosh?

A nuk është përgjegjja në këtë pyetje ajo për të cilën ti duhet të mendosh më së shumti në jetën tënde? Ne shohim një dizajn, planifikim dhe rend madhështor që nga dielli në qiell e deri të ADN-ja në trupin e dikuj. Dhe të mendosh tash se cilado nga këto gjëra mund të jetë rezultat i rastit, është një pohim i papranueshëm, diqka që është e pamundur të mirret seriozisht.

Asnjë Dizajn nuk mund të ndodhë Rastësisht

Ti mund ta kesh parë emrin e ndonjë ndërtese, të bërë me lule në kopsht para saj. Duke shikuar aty poshtë ose edhe që nga larg, menjëherë mund ta kuptosh emrin e ndërtesës apo kompanisë përkatëse. Kjo është shenjë se ato lule nuk janë aty rastësisht por janë vendosur ashtu nga kopshtarët dhe dizajnerët. Ti mund edhe të mos i shohësh kopshtarët duke e bërë atë, por ti e kupton se ajo ka ndodhur, nga emri që ato lule formojnë.

Në mënyrë alternative, le të marrim sikur ti i ke lënë pllakëzat e shkapërderdhura në tavolinë pasi që ke luajtur lojën e mozaikut. Kur kthehesh e sheh se pllakëzat janë në formën e fjalëve: “Unë kam fituar”, dhe ti menjëherë e di se dikush i ka renditur ato në atë radhitje të kuptimtë. Ti kurrë nuk do të mund të imagjinoje se pllakëzat u bashkuan rastësisht dhe i formuan ato fjalë, ashtu sikur kurrë nuk do të mund të imagjinoje se emri që e kanë krijuar lulet është paraqitur rastësisht. Shkurtimisht, nëse ekziston ndonjë dizajn i drejtuar ndaj një caku të caktuar diku, atëherë ti e di se definitivisht duhet të ekzistojë një dizajner mbrapa atij dizajni. Ti mund të mos e kesh parë dizajnerin, sidoqoftë ti mund të jesh i sigurtë në ekzistencën e tij dhe qëllimin e tij nga vepra që ai e ka bërë dhe nga gjurmët që ka lënë prapa vetes.

Ideja kryesore që ne duam të parashtrojmë me këta shembuj është kjo: Nëse ekziston qoftë edhe shenja më e vogël e diqaje të planifikuar diku, atje sigurisht gjenden gjurmët e poseduesit të menqurisë. Për shembull, nëse ti i rrokullis disa gurë të bardhë teposhtë një mali trilion herë, ti kurrë nuk do të kesh shans të shohësh se ata gurë janë bashkuar dhe kanë formuar emrin e një ndërtese. Nëse ekziston ndonjë fjalë apo fjali diku, të gjithë do të pajtohen se ajo fjalë apo fjali do të jetë shkruar nga dikush. Fjalët pa autor, apo dizajnet pa dizajnues janë fare të pamundura.

Trupi i njeriut në anën tjetër posedon një strukturë trilion herë më komplekse se sa emri i një ndërtese apo se sa fjalët “Unë kam fituar”, dhe prapë është tërësisht e pamundur të marrësh me mend se ky kompleksitet mund të ketë ndodhur vetvetiu apo me rastësi. Për më tepër, trilion ADN-të që biliona qenie të gjalla i kanë poseduar gjatë miliona vitesh, janë përdorur në mënyrën më inteligjente, janë shkruar në mënyrën më të përkryer pa asnjë cen, dhe janë vendosur në zona të imta të pakapshme për syrin e thjeshtë. E kjo do të thotë se ekziston një Krijues i cili e ka dizajnuar dhe planifikuar qelizën me ADN-në brenda saj, në mënyrë aq të përsosur. Të pohosh të kundërtën do të thotë të shkosh prapa kufinjëve të arsyeshmërisë dhe të sulmosh vetë themelin e të së vërtetës, arsyes dhe logjikës.

Prapëseprapë, shumë njerëz, të cilët me shumë gatishmëri do të thonë se është e pamundur që disa shkronja të rregullohen vetvetiu dhe të formojnë qoftë edhe tri fjalë të vockla, mund të dëgjojnë pa asnjë vërejtje mashtrimin se ishte rezultat i “koincidencës” ajo që biliona atome u bashkuan një nga një në një renditje të planifikuar dhe formuan një molekulë si ADN-ja, e cila kryen një detyrë aq super-komplekse. Kjo është sikur një person i hipnotizuar i cili i është nënshtruar hipnotizuesit dhe që pranon me sugjestion se ai është derë, dru apo hardhucë...

Shembujt e dizajnit të patëmetë në ADN nuk janë të kufizuar vetëm në rastet e përmendura më lartë. Kodimi i të dhënave në ADN është dizajnuar në mënyrë shumë më fascinante dhe të mahnitshme.

ADN alfabeti

ADN-ja në bërthamën qelizore ka strukturë spirale. Kur kjo do të nxirrej jashtë, ADN-ja kthehet në një fije të hollë me gjatësi prej një metre ose ashtu diqka. Mënyra se si ADN-ja e gjatësisë një metërshe ose afërsisht ashtu diqka, tkurret në bërthamën e vockël qelizore, është temë që do konsideratë të mëtejme.

Atomët që e ndërtojnë ADN-në kanë një dizajn superior që mundëson përmbajtjen e sasisë maksimale të informatës në zonat sa më të vogla që të jetë e mundur. Tri elemente gjenden në secilin hap të fijeve spirale që rrotullohen rreth njëra tjetrës: sheqeri, fosfati dhe bazat organike që përmbajnë hidrogjen të cilat e krijojnë kodin e ADN-së. Edhe pse mënyrat dhe funksionet janë të njëjta tek secili njeri, kodet e veqanta që u mundësojnë njerëzve të jenë të ndryshëm nga njëri tjetri, janë të ndërtuara nga këto baza hidrogjenore. Dallimet në mënyrën e kombinimeve të këtyre katër bazave të ndryshme janë arsyeja e të gjitha dallimeve midis njerëzve. Këto baza janë: Adenina, Guanina, Citozina dhe Timina. Ato lidhen me njëra tjetrën bazuar në rregulla specifike. Sikur një gjuhë e huaj të cilën shkencëtarët sapo kanë filluar të mësojnë ta lexojnë, këto katër tipe të bazave organike hidrogjenore e fshehin në vete tërë kodin e ekzistencës sonë biologjike.

Këto baza që e ndërtojnë molekulën e ADN-së janë të njohura me inicialet e tyre: A, T, G dhe C. Informatat në bankën e të dhënave në bërthamën qelizore janë të deponuara në formën e alfabetit të përbërë nga këto katër shkronja.

Secili gjen, i cili është njësi përbërëse e molekulës së ADN-së, përcakton veti të posaqme të trupit të njeriut. Vetë të panumërta si lartësia, ngjyra e syve, materiali dhe forma e hundës, pastaj veshëve dhe kafkës formohen me komandën e gjeneve të ndërlidhura. Ne mund të krahasojmë secilin nga këto gjene me faqet e një libri. Në faqe gjenden shkrime të përbëra nga shkronjat A-T-G-C.

Në ADN-në e qelizës njerëzore gjenden përafërsisht 200 000 gjene. Secili gjen është i kompozuar nga sekuenca speciale e nukleotideve, numri i të cilave sillet prej 1000 deri në 186 000 sipas tipit të proteinave me të cilat ato korrespondojnë. Këto gjene përmbajnë kodet e përafërsisht 200 000 proteinave që funksionojnë në trupin e njeriut dhe e kontrollojnë prodhimin e këtyre proteinave.

Renditja e gjeneve

Një nga zbulimet më të rëndësishme të biologjisë molekulare është ai se disa gjene janë me influente se sa të tjerat. Arsyeja e kësaj është se gjenet janë të vendosura në një renditje shumë të komplikuar. Në hierarkinë fundamentale gjenetike ekzistojnë disa gjene të cilat janë të ngarkuara me bartjen e funksioneve që përsëriten: krijimi i hemoglobinës, rritja e flokëve ose për shembull prodhimi i enzimeve digjестive. Ekzistojnë gjenet “rregullatore” të vendosura mbi këto molekula punëtore. Këto i shtojnë molekulat punëtore që të punojnë dhe gjithashtu i ndalojnë ato nga të punuarit. Për shembull, ato e ndalojnë nga funksionimi gjenin e hemoglobinës gjatë fëmijërisë. Ekziston një seri e ‘kontrolleve kryesore’ mbi punën edhe të punëtorëve e edhe të ‘drejtuesve të ndërmjetmë’. Vendimi i tyre ndikon në disa, bile edhe deri në qindra sub-njësi. Këto gjene janë aq vitale sa që dëmtimi i tyre gjatë fazës embrionale mund të jetë fatal.

Ky është një fakt që kërkon konsideratë të kujdesshme. Gjenet janë molekula të përbëra nga atomet. E pra, si është e mundur që këto molekula të kenë vendosur një organizim kaq të rregulluar midis tyre? Si mund të ndodhë që një molekulë të marrë vendim për të ndaluar rritjen e dikuj dhe t’ia besojë këtë vendim gjeneve tjera, ashtu që ato ta pranojnë, ti binden dhe ta implementojnë këtë vendim? Kush e ka vendosur këtë disiplinë? Tutje, trilionat gjene në mënyrë të pandërprerë me miliona vite kryejnë të njëjtat funksione, me disiplinën e njëjtë, bindjen, integritetin dhe vetëdijen e njëjtë..

Të thuash tash se një sistem i tillë u shfaq rastësisht është absolutisht e quditshme. Nuk ka dyshim se është Perëndia Ai që i ka programuar gjenet në mënyrë aq të menqur dhe të përsosur.

ADN-ja e sfidon rastësinë

Matematicientët kanë vërtetuar sot se rastësia nuk luan asnjë rol në formimin e informatave të koduara brenda ADN-së. Kur dihet se molekula e ADN-së është e përbërë nga miliona qifte bazash, gjasat e një krijimi të rastësishëm të qoftë edhe të një gjeni të vetëm nga 200 000 sosh që e përbëjnë ADN-në, janë më të pakta se sa edhe fjala “e

pamundur” do ti shprehte. Frank Salisbury, një biolog evolucionist, i thotë fjalët në vijim rreth kësaj “pamundësie”.

Një proteinë mesatare mund të përfshijë deri në 300 aminoacide. Gjeni i ADN-së që kontrollojnë këtë do të ketë 1 000 nukleotide në zingjirin e tij. Duke qenë se ekzistojnë katër lloje të nukleotideve në zingjirin e ADN-së, një zingjirë i tillë i përbërë nga 1 000 lidhje mund të ekzistojë në 4^{1000} forma. Duke përdorur një algjebër të thjeshtë ne shohim se $4^{1000} = 10^{600}$. Kur numri dhjetë shumëzohet me vetveten 600 herë e jep një figurë ku numri 1 ka pas vetes 600 zero! Ky numër është tërësisht jashtë kufinjëve të të kuptuarit tonë.³

Sikur edhe po të supozonim se në një mjedis janë të pranishme të gjitha nukleotidet e nevojshme bashkë me kompleksin e molekulave dhe enzimeve të nevojshme për kombinimin e tyre, gjasat që këto nukleotide të radhiten në sekuencën e dëshiruar janë 1 në 4^{1000} , ose me fjalë tjera 1 në 10^{600} . Shkurt thënë, gjasat e formimit të rastësishëm të kodit të një proteine mesatare të trupit të njeriut në ADN janë 1 me një njësh tjetër të pasuar nga 600 zero. Ky numër, i cili është shumë më larg se sa të jetë astronomik, do të thotë në praktikë: gjasë “zero”. E kjo do të thotë se një sekuencë e tillë duhet të jetë e ndikuar nga kontrolli dhe dituria e një fuqie të menqur dhe të vetëdijshme. Gjasat janë zero që kjo të ndodhë “aksidentalisht” apo “rastësisht”.

Mendo rreth librit që je duke e lexuar pikërisht tani. Si do të reagoje ti ndaj dikuj që do të thoshte se shkronjat janë bashkuar rastësisht nga vetvetiu dhe e kanë formuar këtë shkrim? Është shumë e qartë se libri është shkruar nga një person inteligjent dhe i vetëdijshëm. Njësoj është edhe me ADN-në.

Fransis Crick, biokimisti i cili e zbuloi strukturën e ADN-së ka fituar qmimin Nobël për hulumtimet e kryera në këtë fushë. Crick, i cili ishte një evolucionist i flaktë, dha këtë pohim shkencor në librin që e shkroi pas vërtetimit të strukturës së mrekullueshme të ADN-së: “Një njeri i ndershëm, i armatosur me tërë njohuritë që i kemi në dispozicion tani, mundet vetëm të pohojë se në njëfarë mënyre, origjina e jetës paraqitet në një moment që është gati mrekulli.”⁴ Pra edhe sipas mendimit të Crick-it, i cili ishte një nga ekspertët më të mëdhenjë të ADN-së, jeta kurrë nuk mund të ketë lindur në tokë në mënyrë spontane.

Kur ne kemi parasysh rregullin dhe balancin sensitiv në të dhënat brenda ADN-së, bëhet edhe më e qartë se sa e pamundur është që ato të kenë ardhur në jetë nga rastësia. Të dhënat e ADN-së, që përbëhen nga më shumë se 3 bilionë shkronja, janë të kompozuar nga një sekuencë speciale dhe të kuptimshme të shkronjave A-T-G-C. As edhe një shkronjë e vetme nuk duhet të vendoset gabimisht në këtë sekuencë. Një fjalë e shkruar gabimisht apo një gabim shkronjë në një enciklopedi mund të anashkalohet dhe të injorohet. As që edhe do të vërehet. Sidoqoftë, qoftë edhe një gabim i vetëm në ndonjë nga bazat qifte të ADN-së, si psh një shkronjë e koduar gabimisht në 1 bilion e 719 milion e 348 mijë e 632 qifte bazash, do të shkaktonte rezultate të tmerrshme për qelizën, dhe bashkë me këtë edhe për vetë personin. Për shembull, hemofilia (leukimia) është pasojë e një kodimi të tillë të gabueshëm. Janë disa sëmundje trashëguese që shkaktohen nga disa parregullsi në renditjen gjenetike. E vetmja arsye e këtyre sëmundjeve potencialisht shumë të rrezikshme, është se një apo disa nga miliona shkronjat e kodit gjenetik gjenden në vendin e gabuar. Mongolizmi, apo Sindromi i Daunit është gjërësisht i përhapur. Shkaktohet nga prezenca e një ekstra kromozomi në çiftin 21 të kromozomeve në secilën qelizë. Një shembull tjetër

është sëmundja e Huntingtonit. I godituri nga kjo sëmundje është mjaft i shëndetshëm deri në moshën 35 vjeqare, por pastaj një spazmë e pakontrolluar muskulore paraqitet në duart, këmbët dhe fytyrën e tij. Pasi që kjo sëmundje fatale dhe e pashërueshme afekton edhe trurin, kujtesa dhe fuqia e të menduarit tek i sëmuri progresivisht dobësohen.

Të gjitha këto sëmundje gjenetike e zbulojnë një fakt të rëndësishëm: kodi gjenetik është aq i ndjeshëm dhe i balancuar, dhe i përllogaritur në mënyrë aq minutore, sa që edhe ndryshimet më të vogla mund të kenë pasoja serioze. Një shkronjë më shumë apo një shkronjë më pak mund të qojë deri te një sëmundje vdekjeprurëse apo deri te efekte gjymtuese për tërë jetën. Për këtë arsye është definitivisht e pamundur që të mendosh se një ekuilibër i tillë senzitiv erdhi në jetë nga rastësia dhe u zhvillua nëpërmes mutacionit, ashtu siq mundohet teoria e evolucionit të na bëjë të besojmë. Nëse do të ishte ashtu, si u krijuan dhe si u koduan informatat enorme brenda ADN-së? Evolucionistët, të cilët rrënjët e jetës ua lënë rastësisë, faktikisht nuk kanë asnjë koment për të bërë në temën e rrënjëve të jetës. Kur i pyet ata lidhur me rrënjët e ADN-së, me fjalë tjera kodit gjenetik, merr përgjegjje të njëjtë nga të gjithë ata. Leslie E. Orgel për shembull, një nga biokimistët evolucionistë më të njohur të kohës sonë, ofron përgjegjen në vazhdim:

Ne nuk i kuptojmë as edhe tiparet e përgjithshme të origjinës së kodit gjenetik...Ky është aspekti më enigmatik i problemit të origjinës së jetës dhe mund të nevojiten zbulime të mëdha konceptuale apo eksperimentale para se të bëjmë ndonjë progres thelbësor në këtë drejtim.⁵

Kështu mbesin krejt të stepur ata që pohojnë se miliona faqe, apo biliona pjesë informatash janë shkruar nga rastësia. Ashtu si secili libër apo pjesë informate ka autorin apo pronarin e tij, njësoj e kanë edhe informatat në ADN: dhe ai Krijues është Zoti ynë, poseduesi i diturisë dhe arsyes superiore e të pafundme.

Një Krijim Unik: Vetëreplikimi i ADN-së

Sikur që e dimë, qelizat shumohen me ndarje. Trupi i njeriut fillimisht përbëhet nga një qelizë e vetme e cila pastaj ndahet dhe e reprodukon vetveten shumë herë në proporcionin 2-4-8-16-32...

Qfarë ndodhë me ADN-në në fund të këtij procesi të ndarjes? Ekziston vetëm një zingjir i ADN-së në qelizë. Por, është evidente se qelizës së re të sapokrijuar i nevojitet ADN-ja. Për ta mbushur këtë zbrastësi, ADN-ja kryen një seri interesante të veprimeve, secila fazë e të cilave veprime është një mrekulli tjetër në vetvete. Finalisht, pak para se të ndahet qeliza ADN-ja krijon një kopje të vetvetes dhe e transferon atë në qelizën e re.

Vështirimet në ndarjen e qelizës tregojnë se qeliza duhet të arrijë një madhësi specifike para se të ndahet. Në momentin kur tejkalohet kjo madhësi e veçantë, automatikisht fillon procesi i ndarjes. Përderisa forma e qelizës fillon të bëhet më e sheshuar për të akomoduar procesin e ndarjes, ADN-ja fillon ta replikojë vetveten ashtu siç u përmend më herët.

Kjo do të thotë se qeliza “vendosë” që të ndahet si e tërë dhe pjesët e ndryshme të qelizës fillojnë të veprojnë në pajtim me këtë vendim. Është evidente se qeliza është e lirë nga vetëdija për të kryer një veprim kaq kolektiv. Ndarja e qelizës fillon me një urdhër sekret dhe e tërë qeliza, përfshirë ADN-në vepron në bazë të këtij urdhëri.

Së pari ADN ndahet në dy pjesë për të replikuar vetveten. Kjo ngjarje ndodhë në një mënyrë shumë interesante. Molekula e ADN-së në formë spiraleje ndahet në dy sikur zingjirë duke filluar nga mesi i përdredhjes së spiralit. Prej tash e tutje, ADN ndahet në dy pjesë. Dy gjysmat (replikatat) tjera të që të dy pjesëve krijohen nga materiali i pranishëm në mjedis. Në këtë mënyrë janë prodhuar dy molekula të reja të ADN-së. Në secilën pjesë të operacionit marrin pjesë proteinat eksperte të quajtura “enzime” të cilat funksionojnë sikur një robot i avancuar. Edhe pse duket e thjeshtë në shikim të parë, proceset e ndërmjetme që ndodhin përgjatë këtij operacioni janë aq të shumta dhe aq të komplikuar sa që për ta përshkruar tërë ngjarjen në detaje do të nevojiteshin faqe të tëra.

Një gjë nuk duhet harruar këtu. Enzimet që formohen si rezultat i bashkimit të atomeve e ekzaminojnë njëërën gjysmë të spiralit të ADN-së, i identifikojnë ato pjesë që mungojnë, i marrin këto pjesë nga vendet përkatëse dhe i shtojnë ato aty nevojiten. Në këtë mënyrë ndodhë kopjimi i ADN-së. Mënyra se si këto struktura të imta, të pavetëdije dhe të paarsye, i kryejnë në mënyrë të pandërprerë këto procese kaq komplekse, që kërkojnë vetëdije, dituri dhe arsye, nuk mund të kalohet thjeshtë vetëm duke lexuar për to. Këtu zbulohen disa të vërteta të rëndësishme që duhet pasur në konsideratë.

Molekulat e reja të ADN-së që krijohen pas replikimit kontrollohen në mënyrë të përsëritshme nga enzimet inspektuese. Nëse është bërë ndonjë gabim i cili mund të jetë shumë vital, ai menjëherë identifikohet dhe përmirësohet. Kodi i gabuar largohet dhe zëvendësohet nga tjetri i përmirësuar. Edhe pse të gjitha këto procese kryhen me një shpejtësi verbuese – 3 000 qifte bazash prodhohen në një minutë, - të gjitha këto qifte kontrollohen në mënyrë të përsëritshme nga enzimet që kanë këtë detyrë dhe kryhen ndryshimet e nevojshme. Faktet vijuese që janë veqanërisht të qarta do të krijojnë një të kuptuar më të mirë të shpejtësisë së madhe me të cilën ADN shumohet. Ndarja e një qelize zgjatë midis 20 dhe 80 minuta, dhe informatat në ADN duhet të kopjohen dhe shumohen brenda kësaj kohe të caktuar. Me fjalë tjera, 3 bilion pjesët e informatës në ADN mund të kopjohen në intervalin kohor prej 20 deri 80 minutash pa asnjë gabim apo cen. Kjo është po aq e mrekullueshme sa reproduktimi i përsosur në një interval kaq të shkurtër kohorë, i të gjitha informatave në një bibliotekë, apo i të 1 000 librave, apo i miliona faqeve. Dhe vëreje me kujdes, nuk është ndonjë pajisje teknologjike apo ndonjë fotokopjues i avancuar që e bën këtë, por janë enzimet e formuara nga bashkimi i atomeve.

Në molekulën e re të prodhuar të ADN-së, më shumë gabime se ato normale mund të bëhen si rezultat i faktorëve të jashtëm. Në këtë rast, ribozomet e qelizës fillojnë të prodhojnë enzimet riparuese të ADN-së sipas urdhërit të dhënë nga ADN. Kështu, ADN duke e mbrojtur vetveten gjithashtu garanton edhe ruajtjen e gjeneratës.

Qelizat lindin, shumohen dhe vdesin njësoj sikur qeniet njerëzore. Megjithatë jetëgjatësia e qelizave është shumë më e shkurtër se sa e njeriut që ato e përbëjnë. Për shembull, shumica e qelizave që e përbënin trupin tënd para gjashtë muajve nuk ekzistojnë sot. Megjithëkëtë ti ke mbijetuar sepse ato janë ndarë me kohë dhe u kanë lënë vend qelizave të reja. Për këtë arsye, veprimet shumë të komplikuar siç janë këto të shumimit të qelizave dhe replikimit të ADN-së, janë procese vitale që nuk mund të tolerojnë as edhe një gabim të vogël kur ka të bëjë me mbijetimin e njeriut. Prapsepapë, procesi i shumimit ndodhë aq rrjedhshëm sa që norma e gabimeve është vetëm një në 3 milion qifte bazash.

Dhe ky gabim i vetëm eliminohet nga mekanizmat kontrollues më të lartë në trup pa shkaktuar ndonjë problem.

Pika më interesante është se këto enzime të cilat ndihmojnë në prodhimin e ADN-së dhe që e kontrollojnë kompozimin e saj, janë në të vërtetë proteina të prodhuara sipas informatave të koduara në ADN dhe nën komandën dhe kontrollin e ADN-së. Është ky një sistem kaq i gërshtuar dhe i përsosur në punën e tij sa që është krejtësisht e pamundur që ky sistem ta ketë arritur këtë gjendje me rastësi graduale. Njësoj sikur që ADN-ja duhet të ekzistojë në mënyrë që enzimet të ekzistojnë, ashtu edhe enzimet duhet të ekzistojnë për të ekzistuar ADN-ja, dhe për të ekzistuar që të dyja këtë në anën tjetër, qeliza duhet të ekzistojë si e tërë bashkë me membranën dhe të gjitha organelet komplekse që ajo i përmbanë.

Teoria e evolucionit e cila pohon se qeniet e gjalla evoluojnë ‘hap pas hapi’ si rezultat i ‘rastësive të dobishme’, refuzohet në mënyrë eksplicite nga paradoksi *ADN-enzim* i përmendur më lartë. Kjo është për arsyen se edhe ADN e edhe enzimet duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë. Dhe kjo tregon ekzistencën e një krijimi të vetëdijshëm.

Përgjatë tërë ditës, pa qenë ti fare i vetëdijshëm për këtë, kryhen operacione dhe kontrole të shumta, dhe poashtu shumë masa mirren në trupin tënd me një shpejtësi të pabesueshme dhe në një mënyrë aq të përgjegjshme ashtu që ti të mund ta jetosh jetën tënde pa ndonjë problem. Secila pjesë e vetme e kryen detyrën e saj në mënyrë të suksesshme dhe të tërësishme. Perëndia ka vendosur në shërbimin tënd atome dhe molekula të panumërta, prej më të mëdhave deri tek më të voglat, prej më të thjeshtave deri te më të komplikuarat, ashtu që ti të mund ta jetosh një jetë të mirë dhe të shëndetshme. Favori dhe bekimi i tillë pa kurgjë tjetër është i mjaftueshëm për të merituar falënderimet tona të vazhdueshme.

All-llahu është Ai, që juve ua bëri natën të pushoni në të, e ditën të ndritëshme. All-llahu është dhurues ndaj njerëzve, por shumica e njerëzve nuk falënderojnë. (Kur’ani, 40:61)

Një shembull tjetër i pazotësisë së evolucionistëve: Skenari i ‘Botës së ARN-së’

Qysh nga fillimi i shekullit 20, evolucionistët kanë zhvilluar teori të ndryshme për të sqaruar se si erdhën në jetë qelizat e para të gjalla. Biologu rus Alexander Oparin, i cili propozoi tezën e parë evolucioniste në këtë temë, sugjeroi se në botën primitive të para qindra miliona viteve më herët, një seri e reaksioneve kimike të rastësishme qoi deri të krijimi, i para së gjithash proteinave dhe pastaj qelizat u lindën kur këto (proteina) u bashkuan. Zbulimet e bëra në të shtatëdhjetat e shek 20 treguan se edhe supozimet më fundamentale të këtij pohimi të bërë nga Oparin në vitet e tridhjeta të të njëjtit shekull, ishin të gabuara.

Skenari i “atmosferës primitive të botës” që sipas Oparinit përmbante gazërat metan dhe amoniak, gjoja mundësonte krijimin e molekulave organike. Sidoqoftë, është parë se hipoteza e atmosferës së hershme të përbërë nga metani dhe amoniaku, është pa ndonjë themel solid dhe gjithsesi është kontradiktore dhe pastaj atmosfera e hershme poashtu

përmbante edhe sasi të madhe të oksigjenit i cili shkatërron molekulat organike duke u krijuar.

Kjo ishte një goditje e rëndë për teorinë e evolucionit molekular. Evolucionistët pastaj u desh të ballafaqohen me faktin se “eksperimentet lidhur me atmosferën primitive” të kryera nga Stanley Miller, Sidney Fox dhe Cyril Ponnamperna e të tjerë ishin jovalide. Për këtë arsye, në vitet e tetëdhjeta të shekullit 20 evolucionistët bënë një përpjekje tjetër. Si rezultat u zhvillua hipoteza e “Botës së ARN-së”. Ky skenar propozonte që së pari ishin krijuar, jo proteinat, por molekulat e ARN-së që përmbanin informatat për proteina. Sipas këtij skenari të zhvilluar nga kimisti i Harvardit Walter Gilbert më 1986, biliona vite më parë një molekulë e ARN-së e aftë për ta replikuar vetveten, u formua disi nga rastësia. Pastaj kjo molekulë e ARN-së filloi të prodhojë proteina, duke qenë e aktivizuar nga ndikime të jashtme. Pas kësaj u bë i nevojshëm deponimi i këtyre informatave në një molekulë të dytë dhe kështu disi u shfaq molekula e ADN-së për ta kryer këtë.

Ky skenar fare i pabesueshëm, i përbërë nga zingjirë pamundësishë në secilën fazë të tij, është larg nga të ofruarit e ndonjë sqarimi për origjinën e jetës. Ky vetëm sa e zmadhoi problemin dhe ngriti shumë pyetje që mbeten pa përgjegje:

1. Duke qenë se është e pamundur që të sqarohet krijimi i rastësishëm i qoftë edhe një nukleotidi të vetëm që përbën ARN-në, si është e mundur atëherë që këto nukleotide imagjinare të bashkohen në një sekuencë të veçantë dhe të formojnë ARN-në? Evolucionisti John Horgan e pranon pamundësinë e krijimit të rastësishëm të ARN-së:

Sa më shumë që hulumtuesit vazhdojnë të ekzaminojnë konceptin e botës së ARN-së nga afër, aq më shumë probleme ngrihen. Si u krijua fillimisht ARN-ja? Është shumë vështirë të sintetizohet ARN dhe komponentet e saj nën kushtet më optimale laboratorike e qa më vështirë nën kushtet reale.¹¹

2. Edhe nëse supozojmë se ajo u formua nga rastësia, si është e mundur që kjo ARN e përbërë nga vetëm një zingjirë nukleotidesh, “vendosi” që të vetëreplikohet dhe me qfarë lloji mekanizmi do ta ketë kryer këtë proces vetëreplikimi? Ku i gjeti nukleotidet që i përdori gjatë vetëreplikimit? Edhe mikrobiologët evolucionistë Gerald Joyce dhe Leslie Orgel e shprehin qorrsoakun e kësaj situatë në librin e tyre me titull *Në botën e ARN-së*:

Ky diskutim në një fare mënyre është **fokusuar në njeriun e kashtës: miti i vetëreplikimit të molekulës së ARN-së** që u krijua de novo nga supa e polinukleotideve të rastësishme. Ky nocion jo vetëm që është jorealistik vështuar në dritën e të të kuptuarit të tanishëm të kimisë parabiote, por ai bile edhe do ta **tendosë lehtëbesueshmërinë e pikëpamjes së optimistit lidhur me potencialin katalitik të ARN-së.**¹²

3. Edhe nëqoftëse supozojmë se ekzistonte një ARN vetëreplikuese në botën primordiale, dhe se ishin të pranishme aminoacidet e shumta të çdo lloji, të gatshme për tu përdorur nga ARN, dhe se që të gjitha këto pamundësi disi ndodhën, situata akoma nuk qon drejt formimit të qoftë edhe një proteine të vetme. Sepse ARN përfshin vetëm informatat lidhur me strukturën e proteinave. Aminoacidet, në anën tjetër, janë lëndë të para. Prapëseprapë nuk ekziston asnjë mekanizëm për prodhimin e proteinave. Të konsiderosh ekzistencën e ARN-së të mjaftueshme për prodhimin e proteinave është po aq absurde sa edhe të presësh që një veturë të mbledhet vetvetiu thjeshtë duke e gjuajtur planin e projektvizatimit në grumbullin e pjesëve të përziera njëra mbi tjetrën. Projekti nuk mund të

prodhojë makinën krjet vetvetiu pa fabrikë dhe pa punëtorët që do ti bashkonin pjesët e veturës sipas instruksioneve të përmbajtura në projekt; në të njëjtën mënyrë projekti i gjendur në ARN nuk mund të prodhojë proteina nga vetvetiu pa bashkëpunimin e komponentave tjera qelizore të cilat i pasojnë instruksionet e ARN-së.

Proteinat prodhohen në fabrikat e ribosomeve me ndihmën e enzimeve dhe kjo si rezultat i proceseve skajshmërisht komplekse që ndodhin brenda qelizës. Ribozomi është një organel kompleks i qelizës i përbërë nga proteinat. Kjo, pastaj qon në një supozim tjetër të paarsyeshëm – se ribozomet gjithashtu, do të kenë ardhur në ekzistencë nga rastësia, në të njëjtën kohë. Edhe fituesi i çmimit Nobël Jacques Monod, i cili ishte një nga mbrojtësit më fanatikë të evolucionit, ka sqaruar se sinteza e proteinave në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si e mvarur vetëm nga informatat në acidet nukleike:

Kodi është i pakuptimtë përderisa të mos përkthehet. Makineria përkthyes moderne e qelizës përbëhet nga më së paku 50 komponente makromolekulare, të cilat edhe vetë janë të koduara në ADN: **kodi nuk mund të përkthehet ndryshe vetëm se nga produktet e vetë përkthimit**. Kjo është një e shprehur moderne e *omme vivum ex ovo* [krejt jeta nga vezët, ose në mënyrë idiomatike, kush erdhi së pari, pula apo veza?]. Kur dhe ku u bë i mbyllur ky cikël? **Është një vështirësi marramendëse ta imagjinosh këtë.**¹³

Si ka mundur ta marrë një vendim të tillë zingjiri i ARN-së në botën primordiale, dhe qfarë metode do të ketë përdorur për ta bërë të mundur prodhimin e proteinave duke e kryer punën e 50 komponenteve makromolekulare krejt vetë? Evolucionistët nuk kanë ndonjë përgjegje në këto pyetje.

Dr. Leslie Orgel, një nga kolegët e Stanley Miller dhe Francis Crick nga Universiteti i Kalifornias në San Diego, përdorë termin “skenario” për mundësinë e “formimit të jetës nëpërmjet botës së ARN-së.” Orgel përshkruan se qfarë tiparesh do të duhej të kishte kjo ARN dhe sa gjë e pamundur do të ishte kjo, në artikullin “Origjina e Jetës”, publikuar në *American Scientist* të Tetorit 1994:

Ky skenario do të ndodhte nëse ARN parabolic do ti kishte dy mundësi **që nuk janë evidente sot: Kapacitetin e replikimit pa ndihmën e proteinave dhe aftësinë e katalizimit të secilit hap të sintezës së proteinave.**¹⁴

Sic do të duhej të ishte e qartë deri tash, të presësh këto dy procese komplekse dhe skajshmërisht thelbësore nga një molekulë si ARN-ja është e mundur vetëm në pikëpamjet e evolucionistëve dhe me ndihmën e fuqisë së tyre të fantazisë. Në anën tjetër, faktet konkrete shkencore e bëjnë definitivisht të qartë se hipoteza e “Botës së ARN-së”, e cila është një model i ri i propozuar për krijimin e rastësishëm të jetës, është e barabartë me një përrallëzë të trilluar.

Jeta nuk mund të sqarohet me bashkimin e molekulave të pajeta

Le të harrojmë për një moment të gjitha pamundësitë dhe të supozojmë se një molekulë proteine është formuar në mjedisin më të papërshtatshëm dhe më të pakontrolluar, siç janë kushtet primordiale tokësore.

Krijimi i një proteine të vetme nuk është i mjaftueshëm; kjo proteinë do të duhej të priste durueshëm në këtë mjedis të pakontrolluar pa pësuar asnjë dëmtim, derisa të formohej

rastësisht nën kushtet e njëjta, molekula tjetër pranë saj. Do të duhej të priste derisa të krijoheshin njëra pranë tjetrës miliona proteina korrekte dhe esenciale, të gjitha këto “rastësisht”. Ato të formuara më herët do të duhej të jenë të durueshme dhe të presin mjaftë, pa u shkatërruar, megjithë rrezet ultravjollce dhe efektet e ashpra mekanike. Të presin krijimin e proteinave tjera pranë tyre. Pastaj këto proteina në numër adekuat, të gjitha të krijuara në të njëjtin vend, do të duhej të bashkoheshin në kombinime të kuptimta për të formuar organelet e qelizës. Asnjë material i huaj, molekulë e dëmshme apo zingjir i pavlefshëm proteinash nuk do të duhej të ju interferonte. Pastaj, edhe nëse këto organele do të vinin së bashku në një mënyrë skajshmërisht harmonike dhe bashkë-punuese me plan dhe rregull, ato do të duhej të sillnin pranë tyre të gjitha enzimet e nevojshme dhe të mbështillen me membranë, brendësia e të cilës do të duhej të mbushej me një lëng special për të përgatitur mjedis ideal për to. Tash, edhe në qoftë se të gjitha këto gjëra “shumë të pagjasa” do të ndodhnin nga rastësia, a do të vinte në jetë ky grumbull molekulash?

Përgjegjja është “Jo”, pasi që hulumtimet kanë zbuluar se **kombinimi i thjeshtë i të gjitha materieve esenciale për jetë nuk është i mjaftueshëm për të filluar jeta**. Edhe nëse të gjitha këto proteina esenciale për jetë do të mblidheshin dhe do të vendoseshin në një enë provë, këto përpjekje nuk do të rezultojnë në prodhimin e qelizave të gjalla. Të gjitha eksperimentet e kryera në këtë drejtim janë vërtetuar të jenë të pasukseshme. Të gjitha observimet dhe eksperimentet indikojnë se jeta mund të lindë vetëm nga jeta. Pohimi se jeta ka evoluar nga gjërat jo të gjalla, me fjalë të tjera “abiogjeneza”, është një përrallë e cila ekziston vetëm në ëndrrat e evolucionistëve dhe është krjetësisht në kundërshtim me rezultatet e qfarëdo eksperimenti apo observimi.

Në këtë kuptim, jeta e parë në tokë duhet të ketë origjinuar nga jeta tjetër poashtu. Ky është një reflektim i epitetit “Hayy” të Perëndisë. (I Gjalli, I Përjetshmi). Jeta mund të fillojë, vazhdojë dhe përfundojë vetëm me vullnetin e Tij. Sa i përket evolucionit, ky jo vetëm që e ka të pamundur që ta sqarojë fillimin e jetës, por gjithashtu është i pandihmë të sqarojë se si materialet esenciale për jetë u krijuan dhe u bashkuan.

Chandra Wickramasinghe nga Universiteti i Cardiff-it e përshkruan realitetin me të cilin ai është ballafaquar si shkencëtar të cilit i është thënë gjatë tërë jetës së tij se jeta ka lindur si rezultat i koincidencave të rastësishme:

Qysh nga trajnimi im hershëm si shkencëtar, unë isha programuar që të besoj se shkenca nuk mund të pajtohet me qfarëdo krijimi të paramenduar. Ky nocion u desh të zhveshej dhimbshëm. Në një moment unë nuk mund të gjejë ndonjë argument racional për të hedhur poshtë pikëpamjen e cila kërkon kthim kah Perëndia. Ne kemi qenë mendjehapur; tani e **shohim se përgjegjja e vetme logjike për jetën është krijimi** – dhe jo përzierja e thjeshtë aksidentale.¹⁵

INFORMATAT NË STRUKTURAT E GJALLA DHE VDEKJA E MATERIALIZMIT

Filozofia materialiste qëndron në themele të teorisë së evolucionit. Materializmi mbështetet në supozimin se gjithqka që ekziston është materie. Sipas kësaj filozofie, materia ka ekzistuar qysh nga përjetësia, do të vazhdojë të ekzistojë përgjithmonë dhe nuk ka gjë tjetër pos materies. Për të mbështetur pohimin e tyre, materialistët e përdorin logjikën e quajtur “reduktionizëm”. Kjo është ideja se gjërat që nuk janë të observueshme mund që sqarohen gjithashtu me shkaqe materiale.

Për të qartësuar gjërat le të marrim një shembull nga mendja e njeriut. Është evidente se mendja nuk mund të preket apo shihet. Për më tepër, kjo nuk ka ndonjë qendër në trurin e njeriut. Kjo situatë pashmangshëm qon në konkluzionin se mendja është koncept përtej materies. Kështuqë, qenia të cilës ne i referohemi si “Unë”, e cila mendon, dashuron, nervozohet, brengoset, ndjen kënaqësi apo dhembje, nuk është qenie materiale sikur sofa, dërrasa apo guri.

Materialistët megjithatë pohojnë se mendja është e “thjeshtësuar në materie”. Sipas pohimit materialist, të menduarit, dashuria, brengosja dhe të gjitha aktivitetet tona mentale nuk janë asgjë tjetër veqse reaksione kimike që ndodhin midis atomeve në tru. Dashuria ndaj dikuj është reaksion kimik në disa qeliza në trurin tonë, dhe frika është një tjetër reaksion. Filozofi i famshëm materialist **Karl Vogt** e nënvizoi këtë logjikë me fjalët e tij të famshme “**Ashtu sikur që mëlqia e tajon vrerin, edhe truri ynë e sekreton mendimin.**”

¹⁶ Por vreri është materie, përderisa nuk ka ndonjë fakt se edhe mendja është diqka e tillë.

Reduksionizmi është deduksion (përfundim) logjik. Sidoqoftë, deduksioni logjik mund të bazohet në themel solide apo në themele tundëse. Për këtë arsye, pyetja që ne duhet ta bëjmë është: **Qfarë ndodhë kur reduksionizmi, logjika themelore e materializmit, krahasohet me të dhënat shkencore?**

Shkencëtarët dhe mendimtarët materialistë të shekullit 19 mendonin se përgjigja do të ishte se “shkenca e vërteton reduksionizmin”. Sidoqoftë, shkenca e shekullit 20 ka shfaqur një pamje krjet ndryshe.

Një nga qështjet më të spikatura në këtë pamje është “informata” e cila është prezente në natyrë dhe e cila kurrë nuk mund të reduktohet në materie.

Materia nuk mund të prodhojë informata

Më herët ne kemi përmendur se në ADN-në e qenieve të gjalla ekzistojnë informata jashtëzakonisht gjithëpërfshirëse. Diqka që është e vogël sa e njëqindmijëta pjesë e milimetrit përmbanë një farë “banke të të dhënave” që specifikon të gjitha detajet fizike të trupit të qenies së gjallë. Për më tepër, trupi poashtu e përmbanë sistemin që i lexon këto informata, i interpreton ato dhe e kryen pastaj “prodhimin” në pajtim me to. Në të gjitha qelizat e gjalla, informatat në ADN lexohen nga enzime të ndryshme dhe pastaj prodhohen

proteinat sipas këtyre informatave. Ky sistem e bën të mundshëm prodhimin e miliona proteinave për çdo sekondë, dhe atë të llojit të duhur të proteinës për vendin e duhur në trupin tonë. Në këtë mënyrë, qelizat e vdekura të syrit zëvendësohen me ato të gjalla dhe qelizat e vjetra të gjakut zëvendësohen me të reja.

Le ta konsiderojmë në këtë pikë pohimin e materializmit: A është e mundur që informatat në ADN të reduktohen në materie, siq sugjerojnë materialistët? Ose, me fjalë tjera, a mund të pranohet pohimi se ADN është vetëm një përzierje e materies, dhe se informatat që ajo i përmbanë vijnë si rezultat i interaksioneve të rëndomta të pjesëve të tilla të materies?

Të gjitha hulumtimet, observimet dhe eksperimentet shkencore të kryera në shekullin 20 tregojnë se përgjigja në këtë pyetje është definitivisht “Jo”. Drejtori i Institutit Federal Gjerman për Fizikë dhe Teknologji Prof. Dr. Werner Gitt ka për të thënë këtë lidhur me këtë qështje:

Sistemi i koduar gjithmonë patjetër përfshinë proces intelektual jomaterial. Materia fizike nuk mund të prodhojë kod informatash. Të gjitha përvojat tregojnë se çdo pjesë e informacionit kreativ përfaqëson disa përpjekje mendore dhe mund të lidhet me ide-dhënësin personal i cili e ka vënë në përdorim vullnetin e tij të lirë dhe të cilit i është dhuruar mendja inteligjente...**Nuk ekziston asnjë ligj i natyrës, asnjë proces i njohur dhe asnjë sekuencë ngjarjesh e cila mund të bëjë informatat që të lindin nga materia vetvetiu...**¹⁷

Fjalët e Werner Gitt e përmbledhin konkluzionin e **“teorisë së informatave”**, e cila është zhvilluar në 50 vitet e fundit dhe është pranuar si pjesë e termodinamikës. Teoria informative e investigon origjinën dhe natyrën e informatave në univers. Konkluzioni i arritur nga teoretët informativë si rezultat i studimeve të gjata është se **“Informata është diçka tjetër nga materia. Ajo kurrë nuk mund të reduktohet në materie**. Origjina e informatës dhe ajo e materies fizike duhet hetuar ndaras.”

Për shembull le të mendojmë lidhur me burimin e një libri. Libri përbëhet nga letra, ngjyra dhe informatat që ai i përmbanë. Letra dhe ngjyra janë elemente materiale. Burimi i tyre është prapë materia: Letra është prodhuar nga celuloza dhe ngjyra nga materiet përkatëse kimike. Por, informatat në libër janë jomateriale dhe nuk mund të kenë burim material. Burim i informatës në secilin libër është mendja e personit që e ka shkruar atë.

Për më tepër, kjo mendje e përcakton se si do të përdoren letra dhe ngjyra. Libri primarisht formohet në mendjen e autorit. Autori pastaj e ndërton në mendjen e tij zingjirin e logjikës dhe i rregullon sentencat e tij. Në hapin e dytë, ai i vendos ato në formë materiale, pra mund të thuhet se ai i kryen përkthimin e informatave të mendjes së tij në letër, duke përdorur laps, makinë shkrimi apo kompjuter. Më vonë këto shkronja shtypen në shtëpinë botuese dhe marrin formën e librit të përbërë nga letra dhe ngjyra.

Kështuqë mund ta japim këtë konkluzion të përgjithshëm: “Nëse materia fizike përmbanë informata, atëherë ajo materie duhet të jetë dizajnuar nga një mendje që ka poseduar informatat në fjalë. Së pari është mendja. Ajo mendje i kthen informatat që i posedon, në materie, veprim ky që përbën aktin e dizajnit.”

Origjina e Informatave në Natyrë

Kur e aplikojmë këtë definim shkencor të informatës në natyrë, për pasojë kemi një rezultat shumë të rëndësishëm. Kjo për arsyen se natyra të përmbytë me masën e pafundme të informatave (si për shembull në rastin e ADN-së), dhe duke qenë se kjo informatë nuk mund të reduktohen në materie, ajo pra vie nga një burim tjetër jashtë materies.

Një nga mbrojtësit më të flaktë të teorisë së evolucionit, George C. Williams e pranon këtë realitet të cilin shumica e materialistëve dhe evolucionistëve ngurrojnë ta shohin. Williams në mënyrë të fuqishme e ka mbrojtur materializmin me vite të tëra, por në artikullin që shkroi në vitin 1995, ai i vë në pah jokorrektësitë e qasjes materialiste (reduksioniste) e cila pohon se çdo gjë është materie:

Biologët evolucionistë kanë dështuar të shohin se ata kanë të bëjnë me dy fusha që nuk kanë plotpjestues të përbashkët: me fushën e informatës dhe atë të materies. Këto dy fusha kurrë nuk mund të sillen së bashku në ndonjë koncept të njohur rëndom si “reduksionizëm”. Gjeni është një pako e informatave dhe jo një objekt...Në biologji kur flitet për gjëra si gjenet, gjenotipet dhe grumbujt e gjeneve, flitet për informata e jo për objektiva fizike...**Kjo mungesë e përshkruesve të përbashkët i bën materien dhe informatën dy fusha të ndara të ekzistencës, të cilat duhet diskutuar ndaras, në termet e tyre të veta.**¹⁸

Kështuqë, përkundër supozimeve të materialistëve, burimi i materieve në natyrë nuk mund të jetë vetë materia. Burim i informatës nuk është materia por Menquria superiore jashtë materies. Kjo Menquri ka ekzistuar para materies. Materia është sjellur në ekzistencë, i është dhënë formë dhe është organizuar nga Ai.

NGJASHMËRIA E NJERIUT ME MAJMONIN ËSHTË PËRRALLË!

Kompletimi i hartës së gjenomit njerëzor sot nuk jep rezultatin se njeriu dhe majmuni janë kushërinjë. Nuk duhet mashtruar nga tentimet e evolucionistëve për ta shfrytëzuar këtë zhvillim të ri shkencor ashtu siç kanë bërë me të gjitha zhvillimet tjera.

Sikur që e dimë, kompletimi i tashëm i hartës së gjeneve të njeriut në kuadër të **Projektit të Gjenomit Njerëzor** është një përparim i rëndësishëm shkencor. Por disa rezultate të këtij projekti po shtrembërohen nga disa publikime evolucioniste. Pohohet se **gjenet e shimpanzës kanë 98% ngjashmëri me gjenet e njeriut** dhe kjo promovohet si fakt për pohimin se majmunët janë të lidhur me njerëzit gjë kjo që sjell te teoria e evolucionit. Në të vërtetë, kjo është një pjesë “fallso” e evidencës së promovuar nga evolucionistët të cilët përfitojnë nga mungesa e njohurisë lidhur me këtë temë në shoqëri.

Pohimi për ngjashmëri 98 % është propagandë mashtruese

Së pari, duhet deklaruar se **koncepti i ngjashmërisë 98 përqindëshe midis ADN-së së njeriut dhe shimpanzës**, i përdorur shpesh nga evolucionistët **është mashtrim**.

Për të pohuar se ndërtimi gjenetik i njeriut dhe shimpanzës ka 98 % ngjashmëri, duhet bërë hartën e gjenomit të shimpanzës, njëjtë sikur të njeriut, pastaj këto të dyjat duhet të krahasohen dhe pastaj duhet të nxirret rezultati i këtij krahasimi. Mirëpo nuk ekziston asnjë rezultat i tillë për arsye se deri më tani është bërë harta e vetëm të gjenomit të njeriut. Akoma nuk është bërë ndonjë hulumtim i tillë tek shimpanza.

Në realitet, ngjashmëria 98 përqindëshe midis gjeneve të njeriut dhe shimpanzës, i cili po sillet në agjendë, është një slogan propagandues qëllimisht i krijuar disa vite më parë. Kjo ngjashmëri është një gjeneralizim tejmasë i ekzagjërues, bazuar në ngjashmërinë e sekuencës së aminoacideve të një **30-40 proteinave bazike**, prezente tek njeriu dhe shimpanza. Analiza e sekuencës është bërë duke e përdorur metodën e quajtur “hibridizimi i ADN-së” në sekuencat e ADN-së që janë në korrelacion me këto proteina dhe vetëm ai numër i kufizuar i proteinave është krahasuar.

Mirëpo ekzistojnë rreth njëqind mijë gjene, dhe në bazë të kësaj njëqind mijë proteina të shifruara nga këto gjene tek njeriu. Për këtë arsye, **nuk ekziston asnjë bazë shkencore për pohimin se të gjitha gjenet e njeriut dhe të majmunit janë 98% të ngjashme vetëm për shkak se 40 nga 100 000 proteinat janë të ngjashme**.

Për më tepër, krahasimi i ADN-së kryer në këto 40 proteina është gjithashtu kontraverz. Ky krahasim është bërë në vitin 1987 nga dy biologët Sibley dhe Ahlquist dhe është publikuar në *Journal of Molecular Evolution*.¹⁹ Mirëpo një shkencëtar tjetër i quajtur Sarich, i cili ka ekzaminuar të dhënat e fituara nga këta dy shkencëtarë, ka konkluduar se **besueshmëria e metodës që ata kanë përdorur është kontraverze dhe të dhënat janë interpretuar në mënyrë të ekzagjeruar**.²⁰

ADN i njeriut është poashtu i ngjashëm me atë të krimbit, mushkonjës dhe pulës!

Për më tepër, proteinat bazike të sipër përmendura janë molekula vitale të zakonshme prezente edhe tek qeniet e tjera të ndryshme të gjalla. Struktura e llojit të njëjtë të proteinave prezente jo vetëm te shimpanza, por gjithashtu edhe tek krijesa tjera të gjalla krejtësisht të ndryshme, është shumë e ngjashme me atë të njerut.

Për shembull analizat gjenetike të publikuara në *New Scientist* kanë zbuluar **75% ngjashmëri midis ADN-së së krimbave nematode dhe njeriut**.²¹ Kjo definitivisht nuk do të thotë se ekziston vetëm 25% dallim midis njeriut dhe këtyre krimbave! Sipas trungut familjar të bërë nga evolucionistët, tipi Chordata ku është i përfshirë njeriu, dhe tipi Nematoda ishin shumë të ndryshëm nga njëri tjetri qysh para 530 milion vitesh.

Pastaj një zbulim tjetër i cili poashtu u paraqit në media, thotë se **krahasimet e bëra midis gjeneve të *Drosophila sp.* dhe gjeneve të njeriut tregojnë një ngjashmëri prej 60%**.²²

Në një rast tjetër, analizat e bëra në proteinat e caktuara e paraqesin njeriun poaq afër të lidhur me qenie të tjera të gjalla të ndryshme. Në një hulumtim të kryer nga hulumtuesit e Universitetit të Kembrigjit janë krahasuar disa proteina të kafshëve tokësore. Quditërisht, në gati të gjithë shembujt, **qeniet njerëzore dhe pulat janë qiftëzuar si kushërinjtë më të afërt**. Kushërimi tjetër më i afërt ishte krokodili.²³

Një shembull tjetër i përdorur nga evolucionistët lidhur me “ngjashmërinë gjenetike midis njeriut dhe majmunit”, është **prezenca e 48 kromozomeve tek shimpanzat dhe gorillat krahas 46 kromozomeve tek njeriu**. Evolucionistët e konsiderojnë afërsinë e numrit të kromozomeve si indikacion të lidhjes evolutive. Por, nëse logjika e tillë e përdorur nga evolucionistët do të ishte valide, atëherë njeriu do ta kishte një kusheri edhe më të afërt se sa shimpanza: **“pataten”!** Për arsye se numri i kromozomeve tek patatja është i njëjtë me atë tek njeriu: 46

Këta shembuj konfirmojnë se koncepti i ngjashmërisë gjenetike nuk përbën evidencë për teorinë e evolucionit. Kjo për arsyen se ngjashmëritë gjenetike nuk janë në linjë me skemat e supozuara evolucioniste, dhe përkundrazi, këto tregojnë rezultate krejtësisht të kundërta.

Ngjashmëritë gjenetike e shqetësojnë “Skemën Evolucioniste” e cila kërkohet të Konstituohet

Nuk është aspak befasi se kur kjo qështje vlerësohet si e tërë, shihet se tema e “ngjashmërisë biokimike” nuk konstituon evidencë për evolucionin por e hudhë këtë teori në greminë. Dr. Christian Schwabe, hulumtues biokimist nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e South Carolina, është një shkencëtar evolucionist i cili ka kaluar vite të tëra duke kërkuar evidencë për evolucionin në fushën molekulare. Në veqanti ai ka kryer hulumtime në proteinat e tipit të insulinës dhe relaksinës dhe ka tentuar që të krijojë një afërsi evolutive midis qenieve të gjalla. Mirëpo, atij i është dashur të pranojë shumë here se ai nuk ka mundur të gjejë ndonjë evidencë për evolucionin në ndonjë pikë të studimeve të tij. Në një artikull të publikuar në një revistë shkencore, ai thotë:

Evolucioni molekular është duke u pranuar si metodë më superiore ndaj asaj paleontologjike për zbulimin e afërsive evolutive. Si evolucionist molekular unë do të duhej të isha i ngazëllyer. Në vend të kësaj duket turbullues fakti se ekzistojnë shumë përjashtime në progresionin e renditur të specieve përcaktuar sipas homologjisë molekulare: këto janë aq të shumta në të vërtetë sa që unë mendoj se përjashtimi mund të bartë ne vete porosi më të rëndësishme.²⁴

Bazuar në zbulimet e vonshme në fushën e biologjisë molekulare, biokimisti i famshëm Prof. Michael Denton ka dhënë këto komente:

Secila klasë e nivelit molekular është unike, e izoluar dhe e palidhur me ndërmjetësues. Kështuqë, molekulat, njësoj sikur fosilet kanë dështuar të sigurojnë ndërmjetësuesit e pakapshëm të kërkuar aq gjatë nga biologjia evolucioniste...**Në nivelin molekular asnjë organizëm nuk është “më i vjetër” ose “më primitiv” apo “më i avancuar” krahasuar me të afërmit e tij...**Ka pak dyshim se sikur këto fakte molekulare të ishin të pranishme para një shekulli...ideja e evolucionit organik mund të mos ishte pranuar kurrë.²⁵

Ngjashmëritë nuk janë vërtetim për evolucionin por për krijimin

Sigurisht se është e natyrshme për trupin e njeriut që të ketë disa ngjashmëri molekulare me qeniet e tjera të gjalla, për arsye se të gjitha këto janë të ndërtuara nga qelizat e njëjta, të gjitha përdorin ujin dhe atmosferën e njëjtë, të gjitha konsumojnë ushqimin e përbërë nga molekulat e njëjta. Sigurisht se metabolizmi i tyre dhe me këtë edhe ndërtimi i tyre gjenetik do ti përgjasojë njërti tjetrit. Megjithatë, ky nuk është vërtetim se ato kanë evoluar nga paraardhës të përbashkët.

Ky “material i njëjtë” nuk është rezultat i evolucionit por i “dizajnit të njëjtë”, që do të thotë se ato janë krijuar sipas planit të njëjtë.

Është e mundur të sqarohet kjo qështje me një shembull: të gjitha konstruksionet në botë janë të ndërtuara me material të ngjashëm (tulla, hekur, qimento, etj). Por kjo nuk do të thotë se këto ndërtesa kanë “evoluar” nga njëra tjetra. Ato janë ndërtuar ndaras duke përdorur materialin e rëndomtë. E njëjta gjë vlen edhe për qeniet e gjalla poashtu.

Jeta nuk ka filluar si rezultat i rastësive të pavetëdijshme siç pohon evolucioni, por si rezultat i krijimit nga Perëndia, i Gjithëfuqishmi, Poseduesi i diturisë dhe menqurisë të pafund.

Ai (All-llahu) është që krijoi (pa kurrfarë shembulli) qiejt dhe tokën, e si mund të ketë Ai fëmijë kur nuk pati bashkëshorte? çdo send e krijoi Ai, dhe është më i dijshmi për të gjitha sendet e krijuara. Ky është All-llahu, Zoti juaj, nuk ka të adhuruar përveç Tij, Krijues i çdo sendi, pra adhuronie Atë; Ai është mbikëqyrës ndaj çdo sendi. (Kur’ani, 6:101-102)

Konkluzion

Si shtesë e krejt informatave që i kemi shqyrtuar deri më tash, ne mendojmë se do ishte ndihmesë theksimi i një fakti tjetër.

Përveq ngjashmërisë sipërfaqësore midis tyre, majmunët nuk janë më të afërt me qeniet njerëzore se sa ndonjë shtazë tjetër. Për më tepër, kur përdoret intelegjenca si mjet i krahasimit, bleta e cila prodhon mrekullinë gjeometrike të huallit, apo merimanga e cila e prodhon mrekullinë inxhinierike të rrjetës, janë më të afërta me njeriun se sa majmuni. Ne bile edhe mund të themi se ato janë më superiore në disa aspekte.

Sidoqoftë, midis njeriut dhe majmunit ekziston një zbrastësirë marramendëse e cila kurrë nuk mund të mbyllet me trille e përralla. Fundja, majmuni është një shtazë pa asnjë dallim me kalin apo qenin në aspektin e vetëdijes. Njeriu, në anën tjetër është qenie me vetëdije dhe vullnet, e cila mund të mendojë, arsyetojë, vendosë dhe gjykojë. Të gjitha këto kualitete janë funksione të ‘shpirtit’ që ai posedon. Dallimi më i rëndësishëm që e shkakton këtë zbrastësirë gjigante midis njeriut dhe qenieve tjera të gjalla është ky “shpirt”. Asnjë ngjshmëri fizike nuk mund ta afrojë këtë zbrastësirë midis njeriut dhe qenieve tjera të gjalla. E vetmja krijesë në natyrë që ka “shpirt” është njeriu.

Ky kualitet superior të cilin e posedon njeriu dhe i cili e dallon atë nga qenie e tjera të gjalla, në Kur’an referohet si:

Mandej, Ai e formëson atë (në barkun e nënës) dhe nga ana e vet i jep shpirt atij dhe Ai është që juve ju pajis edhe me dëgjim, me të parit dhe me zemër, e pak send është ajo që ju falënderoni. (Kur’ani 32:9)

IDETË E GABUARA DARVINISTO-MATERIALISTE RRETH PROJEKTIT TË GJENOMIT NJERËZOR

Me bërjen të njohur të të arritave të fundit në Projektin e Gjenomit Njerëzor, disa institucione publikuese kanë filluar të përhapin mesazhe çorientuese duke e keqinformuar publikun, ashtuqë rruga pa krye ku ka mbërrirë evolucioni të mos bëhet e ditur edhe më tutje.

Më herët, ne përmendëm mesazhet mashtruese të evolucionistëve rreth “ngjashmërive gjenetike” dhe e bëmë të qartë se këto janë interpretime subjektive të cilat nuk sjellin ndonjë fakt për teorinë e evolucionit. Një temë tjetër e cila po promovohet dhe po theksohet me të madhe nën slogane e tituj të ndryshëm nga shtypi Darvinisto-Materialist, është pohimi se zbulimi i hartës së gjeneve sugjeron se fati i caktuar nga Perëndia mund të sfidohet.

Ky është një keqkuptim dhe mashtrim i madh i trumbetura nga qarqe të ndryshme. Titujt që po paraqiten tash vonë në shtypin e shkruar dhe deklaratat e bëra në diskutime në programet televizive japin impresionin e një indoktrinimi tinzar. Është një gabim i madh prezantimi i informatave nga projekti i gjenomit njerëzor, i shoqëruar nga mesazhe si “Njeriu më nuk do të jetë i mundur nga fati i tij”. Sepse në fakt, hartimi i gjenomit njerëzor nuk ka kurrfarë rëndësie në rrjedhjen e fatit të njeriut. Prodhimi i hartës së gjeneve të njeriut në asnjë mënyrë nuk do ta ndërrojë formën e fatit të njeriut, për arsye se ai gjithashtu është i parapërcaktuar.

Rrjedhja e Fatit nuk mund të ndërrojë

Fati është njohuria e përsosur e Perëndisë për të gjitha ngjarjet, të tashmet apo të ardhmet, sikur një moment i vetëm. Zoti veqse i di ngjarjet të cilat akoma nuk kanë ndodhur. Një numër i madh i njerëzve nuk mund të kuptojnë se si Perëndia mund të dijë se çfarë do të ndodhë në të ardhmen, me fjalë të tjera se mund ta dijë realitetin e fatit. Sidoqoftë “ngjarjet të cilat akoma nuk kanë ndodhur” janë të tilla vetëm për neve. Të gjitha ato ngjarje rezultatin e të cilave ne e përshkruajmë si të “panjohur” janë “të panjohura” vetëm për neve. Zoti i cili e posedon njohurinë e pafundme nuk është i kufizuar nga koha dhe hapësira. Në asnjë mënyrë, sepse ishte Ai që e krijoi kohën dhe hapësirën. Për këtë arsye e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja janë që të gjitha njësoj për Zotin; për Të çdo gjë veqse ka ndodhur dhe është kryer. Çdo gjë që neve na ndodhë tani dhe që do të na ndodhë në të ardhmen, është veqse e mbaruar dhe e kryer në shikimin e Perëndisë. Në kohën e duhur të gjithë njerëzit e takojnë fatin që Perëndia e ka përgatitur për ta.

Ashtu sikur dikush që e ka në dorë shiritin e një filmi dhe që mund ta shohë fillimin, fundin dhe gjithqka që është në mes si një tërësi të vetme, njësoj Zoti di çdo gjë rreth qenieve njerëzore që Ai i ka krijuar. Zoti i cili di gjithqka si në një moment të vetëm, e ka

shpallur Fuqinë e tij ndaj nesh duke e krijuar pafundësinë, ose kohën pafundësisht të gjatë, në një moment të vetëm, e kjo do të thotë, në një kohë pafundësisht të shkurtër.

Perëndia ka krijuar çdo njeri të në kaluarën dhe të tashmen duke e ditur çdo detaj të jetës së tyre. Qfarëdo që do ti ndodhë dikuj, qoftë kjo e mirë apo e keqe në sytë e tij, ndodhë mbrenda dijes së Perëndisë. Sura An'am zbulon se gjithqka që ndodhë në këtë botë, qoftë kjo e vogël apo e madhe ndodhë me vullnetin e Perëndisë:

çelësat e fshehtësive janë vetëm tek Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush pos Tij. Ai e di çka ka në tokë dhe në det, Ai e di për çdo gjeth që bie dhe s'ka kokërr në thellësi të tokës, s'ka të njomë dhe s'ka të thatë që nuk është (shënuar) në librin e qartë. (Kur'ani 6:59)

Kjo është e vërtetë për secilin njeri dhe për secilën ngjarje. As nuk është e mundur që që dikush ta ndërrojë fatin që Perëndia e ka përgatitur për të, e as që është e mundur që të bëhet të ngjajë ndonjë ndryshim në rrjedhjen e ngjarjeve. Perëndia e ka krijuar secilin me jetëzgjatje të caktuar dhe momenti i vdekjes është caktuar (vendi, koha dhe forma) në vështirimin e Perëndisë. Për shembull, sëmundja nga e cila do të vuajë ndonjë person është paracaktuar me biliona vite para lindjes së tij. Se a do të shërohet apo jo ai njeri nga ajo sëmundje është vendosur nga Zoti në fatin e tij. Edhe mjekët, infermierët, spitalet dhe metodat e trajtimit që do të jenë motor i shërimit të tij janë të shkruara që më pare në vështirimin e Perëndisë. Për këtë arsye, fakti që dikush shërohet nga ndonjë sëmundje nuk do të thotë se ai ka mashtuar fatin e tij, por kjo do të thotë se shërimi i tij është pjesë e fatit të njëjtë.

Nëse, në vitet që vijnë, jeta e dikuj zgjatet me intervenime kohore në gjene, kjo nuk do të thotë se kjo ngjarje e ka mposhtur fatin e atij personi. Kjo, thjeshtë, do të thotë kështu: Perëndia i ka dhënë këtij personi jetë të gjatë dhe se Ai e ka bërë përfundimin e hartës së gjeneve si mjet që jeta e tij të jetë e gjatë. Zbulimi i hartës së gjeneve, të jetuarit e atij personi në atë kohë dhe zgjatje e jetës së tij me metoda shkencore janë që të gjitha fati i tij. Krejt kjo është përcaktuar në sytë e Perëndisë para se ai person të vinte në këtë botë.

Njësoj, dikush sëmundja fatale e të cilit është kuruar nëpërmjet zbulimeve të bëra në spektrin e këtij projekti, prapë nuk e ka ndërruar fatin e tij. Kjo për arsye se është fati i atij personi që të shërohet nga ajo sëmundje nëpërmes mjeteve të këtij projekti.

Rrjedhimisht, kompletimi i projektit të gjenomit njerëzor dhe fakti se ai njeri do të mund të intervenojë në ndërtimin gjenetik, nuk do të thotë konfrontim i fatit të krijuar nga Perëndia. Përkundrazi, në këtë mënyrë njerëzimi i përcjell zhvillimet e krijuara për të nga Perëndia, dhe gjurmon e përfiton nga informatat e krijuara nga Perëndia. Nëse njeri jeton 120 vite falë këtyre zhvillimeve shkencore, kjo sigurisht është jetëzgjatje e dekretuar për të nga Zoti, dhe për këtë arsye ai ka jetuar aq gjatë.

Zoti ka shpallur në një ajet se jeta e secilit njeri është e paraqitur në një libër në sytë e Tij:

All-llahu ju krijoi prej dheu, mandej prej një pike uji, e pastaj ju bëri çift. E asnjë femër nuk bart e as nuk lind ndryshe, vetëm se me dijen e Tij, dhe nuk i jepet

kujt të jetojë gjatë ose t'i shkurtohet jeta e tij, vetëm se ajo është e shënuar në Libër, e kjo për All-llahun është e lehtë. (Kur'ani 35:11)

Studenti i cili bie nga provimi pranues në universitet për disa vite para se të pranohet në degën ku ai dëshiron, biznesmeni i cili e shpëton kompaninë e tij nga bankrotimi, njerëzit të cilin i ikin në momentin e fundit një rrëmbimi të aeroplanit, dhe të tjerët që bëjnë gjëra të njëjta, që të gjithë vetëm janë duke e jetuar fatin e tyre. Askush nga ta nuk mund ta ndërrojë atë fat, e as që dikush tjetër ka fuqi për ta ndërruar fatin e tyre për ta.

Shkurtimisht thënë, shprehjet si “E kam mashtruar fatin”, “E kam ndërruar fatin” apo “Kam intervenuar në fatin tim” janë si pasojë e injorancës të shkaktuar nga mosnjohja e fakteve rreth fatit. Në anën tjetër, edhe personi që i përdorë këto shprehje gjithashtu është i parapërcaktuar: kur, si dhe nën qfarë kushtesh ai do ti thotë këto gjëra, janë që të gjitha të përcaktuara në sytë e Perëndisë. Është Zoti Ai që i di të gjitha.

Perëndia na ka informuar se çdo gjë është e regjistruar në një libër të qartë në sytë e Tij. Ne jetojmë atë që është e shkruar në atë libër, as më shumë as më pak.

E ata që nuk besuan thanë: “Nuk do të na vijë neve kijameti!” Thuaj: “Po. pasha Zotin tim që e di të fshehtë, pa tjetër do t'ju vijë ai juve. Atij nuk mund t'i fshihet as në qiell as në tokë sendi sa grimca, e as më i vogël, e as më i madh, vetëm se janë të regjistruar në librin e qartë”. (Kur'ani 34:3)

Nuk ndodh asnjë fatkeqësi në tokë e as në trupin tuaj, e që të mos jetë në shënime para se të ngjajë ajo, e kjo për All-llahun është e lehtë. (Kur'ani 57:22)

Klonimi i qenieve njerëzore apo gjallesave tjera nuk është krijim

Në disa publikime është pohuar se me përparimin e shkencës së gjenetikës, qeniet njerëzore do të klonohen dhe kështu njerëzit do të krijojnë njerëz. Kjo gjithashtu është një pjesë shumë e shtrembëruar dhe e panatyrshme e logjikës. Të krijosh do të thotë të sjellësh diçka në jetë nga asgjëja, dhe ky veprim është privilegj vetëm i Perëndisë. Formimi i kopjes identike së qenies së gjallë duke kopjuar informatat gjenetike nuk do të thotë se ajo qenie e gjallë është krijuar. Kur një njeri apo ndonjë qenie tjetër e gjallë është klonuar, qelizat e qenies së gjallë janë marrë dhe kopjuar. Sidoqoftë, njeriu kurrë nuk e ka krijuar nga asgjëja as edhe një qelizë e vetme. Hulumtimet e kryera në këtë drejtim janë stopuar: që të gjitha ishin fare jobindëse.

Rrjedhimisht, zbulimi i ndërtimit gjenetik të njeriut në asnjë mënyrë nuk implikon sfidim të njeriut ndaj fatit të tij, dhe kjo kurrë nuk do të mund të ndodhë. Çdo incident, çdo akt i të folurit dhe të zhvilluarit është i paracaktuar në sytë e Perëndisë sipas fatit përkatës. Njësoj vlen edhe për përparimet teknologjike, zhvillimet shkencore dhe inovacionet që ato do të sjellin. Zoti është i Gjithëdijsëm dhe Gjithëpërfshirës. Fakti se çdo gjë, e madhe apo e vogël, ndodhë brenda njohurisë së Perëndisë është përmendur në Kur'an:

Ti nuk angazhohesh me asnjë çështje, nuk lexon pjesë nga Kur'ani dhe nuk bëni ndonjë vepër, vetëm se ne jemi prezentuesit tuaj, kur ju ndërmerrni atë. Zotit tënd nuk mund t'i fshihet as në tokë e as në qiell as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe, por vetëm sa është evidentuar në librin e sigurtë. (Kur'ani 10:61)

POHIMET E FUNDIT LIDHUR ME MBËSHTJETJEN FOSILE TË TEORISË SË EVOLUCIONIT GJITHASHTU JANË TASHMË HISTORI

Teoria e evolucionit ka pësuar disfatë të zhurmshe në paleontologji sikur edhe në fushat e biokimisë siç janë gjenet, ADN dhe sistemi qelizor. Fosilet demonstrojnë se speciet e gjalla nuk kanë evoluar nga njëra tjetra, por janë krijuar ndaras me karakteristikat e tyre specifike individuale.

Sipas teorisë së evolucionit që të gjitha speciet e gjalla kanë evoluar nga njëra tjetra. Speciet e mëhershme ekzistuese me kohë u shëndërruan në specie tjera dhe që të gjitha speciet u krijuan në të njëjtën mënyrë. Sipas kësaj teorie, ky transformim ka ndodhur brenda një periudhe të gjatë prej qindra miliona vitesh dhe është zhvilluar gradualisht.

Në atë rast, “specie të ndërmjetme” të shumta, do të duhej të ishin krijuar dhe do të kishin jetuar brenda kësaj periode të gjatë të supozuar të transformimit.

Për shembull, disa krijesa gjysëm-peshk/gjysëm-zvarranik do të duhej të kishin jetuar në të kaluarën gjë që do të kuptonte shtim të disa tipareve të zvarranikëve në tiparet ekzistuese të peshqve tek këto krijesa. Ose disa zvarranikë-shpendë do të duhej të kishin ekzistuar gjë që do të kërkonte shtim të disa tipareve të shpendve në tiparet ekzistuese të zvarranikëve të cilat këto krijesa veqse i kishin. Duke qenë se këto krijesa ishin në periudë tranzitore, ato do të duhej të ishin të gjymta, të mangëta dhe defektive. Evolucionistët u referohen këtyre krijesave teorike, për të cilat besojnë që të kenë jetuar në të kaluarën, si **“forma tranzitore”**.

Nëse shtazët e tilla do të kishin ekzistuar me të vërtetë në të kaluarën, tash do të kishim miliona e bile edhe biliona sosh në numër dhe varietet.

Darvinizmi po shpartallohet mu në këtë pike, për arsye se nuk ekziston as edhe një gjurmë e vetme e këtyre “formave të ndërmjetme tranzitore” imagjinative.

Ky fakt ka qenë i njohur për një kohë të gjatë. Megjithatë evolucionistët akoma spekulojnë rreth disa fosileve, duke tentuar që ti prezantojnë ato si “forma të ndërmjetme tranzitore” dhe e ngushëllojnë vetveten duke thenë se “vetëm disa forma të ndërmjetme janë gjetur deri më tash por në të ardhmen të gjitha ato do të zhgroposen”. Fosili më i rëndësishëm i paraqitur si formë e ndërmjetme ka qenë fosili 150 milion vite i vjetër i shpendit të vdekur i quajtur Archaeopteryx. Evolucionistët pohonin se ky shpend kishte tipare të zvarranikëve. Megjithë faktin se pohimet e tyre janë përgënjeshtuar një nga një dhe se është vërtetuar se Archaeopteryx-i nuk ishte një formë e ndërmjetme tranzitore por një specie shpendi që fluturonte, ata dëshpërueshëm kapen për këtë fosil të fundit që e kanë.

“Zbulimi fosil kërcënon teorinë e evolucionit të shpendëve”

Një fosil i zbuluar gjatë viteve të fundit definitivisht i përmbysi pohimet e evolucionistëve. Cituar nga burime evolucioniste, është gjetur një fosil i cili zbuloi se paraardhësi i lashtë i shpendëve nuk ishte dinosaur apo ndonjë qenie tjetër e gjallë por shpend.

Lajmet rreth këtij zbulimi së pari u paraqitën në mediat botërore më 23 Qershor 2002. Në *New York Times* u paraqit titulli **“Zbulimi fosil kërcënon teorinë e evolucionit të shpendëve”**. Ishte ky një artikull rreth një shpendi të zhgroposur kohëve të fundit në Lindjen e Mesme. Revistat shkencore prominente si *Science* dhe *Nature* sikur dhe rrjeti i famshëm televiziv BBC shpallën zhvillimet e fundit si vijon: “është zbuluar se fosili i zhgroposur në Lindjen e Mesme i cili llogaritet të ketë jetuar para 120 milion vitesh, është i mbuluar me pupla, e ka shporin (pamëzën) mu sikur Archaeopteryx-i dhe shpendtë e tjerë të kohës së sotme, dhe se ka boshite të zbrazëta në puplat e tij. **KJO I BËN JOVALIDE POHIMET SE ARCHAEOPTERYX-I ËSHTË PARAARDHËS I SHPENDVE**, për arsye se fosili i zbuluar është 75 miliona vite më i vjetër se Archaeopteryx-i. Kjo do të thotë se **SHPENDI I VËRTETË ME TË GJITHA TIPARET E TIJ KARAKTERISTIKE VEQSE KA EKZISTUAR 75 MILION VITE PARA KRIJESËS E CILA SUPOZOHEJ TË JETË PARAARDHËS I SHPENDVE.**”

Një moment gjigand në historinë e Paleontologjisë

Pranimi nga vetë evolucionistët se Archaeopteryx-i nuk është ‘formë e ndërmjetme tranzitore’ që do të shërbente si evidencë për evolucionin është një kthesë e madhe e rendësishme në historinë e paleontologjisë. Kjo për arsyen se për afër 150 vite Archaeopteryx-i vazhdonte të ishte më prominenti midis shumë pak të ashtuquajturave ‘forma të ndërmjetme tranzitore’, të cilat evolucionistët kishin mundur ti zhvillojnë. Sidoqoftë, kjo derë e shpëtimit tashmë është e mbyllur gjithashtu dhe bota e paleontologjisë duhet të ballafaqohet me të vërtetën e thjeshtë se **nuk ekziston as edhe një fosil i vetëm i cili do të sillte ndonjë evidencë për evolucionin.**

Rezultati është evident. The New York Times gjithashtu ka pranuar faktin dhe e ka vënë në faqen e parë titullin **“Zbulimi fosil kërcënon teorinë e evolucionit të shpendëve”**. Kjo është e vërtetë. Paraardhësi i shpendve ishte shpend. Paraardhësi i peshqve ishte peshk, paraardhësi i kuajve ishte kali, paraardhësi i kengurëve ishte kengur dhe paraardhësi i njerëzve ishte njeri. Me fjalë të tjera, **që të gjitha klasët e ndryshme të qenieve të gjalla u shfaqën në formën e përsosur dhe specifike që e kanë sod. Thënë ndryshe, ato u krijuan nga Perëndia.**

Rezistenca konzervative që evolucionistët e tregojnë ndaj këtij fakti evident tani e ka humbur edhe gurin e fundit të themelit.

Thanë: “Ti je i pa të meta, ne kemi dije tjetër përveç atë që na mësove Ti. Vërtetë, Ti je i gjithdijshëmi, i urti!” (Kur’an 2:32)

SHĚNIME

- 1 Michael Denton, *Evolution: A Theory in Crisis*, London: Burnett Books, 1985, fq. 334.
- 2 Prof. Dr. Ali Kemirsoy, Kalitim ve Evrim, p. 158
- 3 Frank B. Salisbury, "Doubts about the Modern Synthetic Theory of Evolution" fq. 336.
- 4 Francis Crick, *Life Itself: It's Origin and Nature*, New York, Simon & Schuster, 1981, fq. 88.
- 5 Orgel. Leslie E. "Darwinism at the Very Beginning of Life," New Scientist, vol. 94 (April 15, 1982), fq. 151
- 6 Pierre-P Grassé, *Evolution of Living Organisms*, New York: Academic Press, 1977, fq. 103.
- 7 Douglas R. Hofstadter, *Gödel, Escher, Bach: An Eternal Golden Braid*, New York, Vintage Books, 1980, fq. 548
- 8 Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on the Earth", *Scientific American*, October 1994, vol. 271, fq. 78.
- 9 Haskins, Caryl P. , "Advances and Challenges in Science in 1970," American Scientist, vol. 59 (May/June 1971), fq. 305
- 10 Michael Denton, *Evolution: A Theory in Crisis*. London: Burnett Books, 1985, fq. 351.
- 11 John Horgan, "In the Beginning", *Scientific American*, vol. 264, February 1991, fq. 119.
- 12 G.F. Joyce, L. E. Orgel, "Prospects for Understanding the Origin of the RNA World", *In the RNA World*, New York: Cold Spring Harbor Laboratory Press, 1993, fq. 13.
- 13 Jacques Monod, *Chance and Necessity*, New York: 1971, fq.143.
- 14 Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on the Earth", *Scientific American*, October 1994, vol. 271, fq. 78.
- 15 Chandra Wickramasinghe, Interview in *London Daily Express*, August 14, 1981.
- 16 Encyclopaedia Britannica, "Modern Materialism"
- 17 Werner Gitt, *In the Beginning Was Information*, CLV, Bielefeld, Germany, fq. 107, 141.
- 18 George C. Williams. *The Third Culture: Beyond the Scientific Revolution*, (ed. John Brockman) New York, Simon & Schuster, 1995, fq. 42-43
- 19 Journal of Molecular Evolution, vol. 26, fq. 99-121
- 20 Sarich et al. 1989. Cladistics 5:3-32
- 21 *New Scientist*, 15 May 1999, fq. 27
- 22 <http://news.vvc.co.uk/1/hi/sci/tech/specials/washington-2000/647139.stm>
- 23 *New Scientist*, v. 103, 16 August 1984, fq. 19
- 24 Christian Schwabe, "On the Validity of Molecular Evolution", *Trends in Biochemical Sciences*, July 1986
- 25 Michael Denton, *Evolution: A Theory in Crisis*. London: Burnett Books, 1985, fq. 290-291.